

RAPORT

I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

Për Programin e studimit Msc Financë -bankë me profile:

- Banka dhe tregje financiare
- Ekonomi - financë

Ofruar nga Universiteti European i Tiranës

Ekspertët e vlerësimit të jashtëm:

Prof.Dr. Halit XHAFA
Prof.Dr. Drini SALKO



(Maj / 2018)



RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e studimit Msc Finance - bankë me profile:

- Banka dhe tregje financiare
- Ekonomi - financë

Tabela e të dhënave për programin e studimit	
1	IAL Aplikues:
2	Fakulteti që e ofron
3	Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit
4	Urdhëri/VKA e Akreditimit të parë
5	Titulli i programit të studimit: Msc në Financë - bankë me profile: <ul style="list-style-type: none"> • Banka dhe tregje financiare • Ekonomi - financë
6	Cikli i studimit:
7	Kohëzgjatja e programit të studimit:
8	Kreditet në total (ECTS):
9	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):
10	Gjuha (shqip/tjetër):
11	Programi ofrohet nga institucioni
12	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera
13	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):
14	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):
15	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve
16	Aktivizimi i programit të studimit
17	Numri i studentëve për program studimi

* Të dhënat për numrin e studentëve i përkasin viteve akademike 2016-2017 dhe 2017-2018

Shenim: Tabela plotësohet nga Specialisti i ASCAL

HYRJE

Të dhëna për programin e studimit Msc në Financë - bankë me profile: Banka dhe Tregje Financiare Ekonomi - financë

Universiteti European i Tiranës si institucion i Arsimit të Lartë është krijuar fillimisht si Shkollë e Lartë Universitare Jo Publike me VKM nr. 636 datë 20.09.2006 të Këshillit të Ministrave, "Për dhënien e lejes për hapjen e Shkollës së Lartë Universitare Jo Publike. Emërtimi aktual i UET është bërë me VKM nr. 657, datë 28.09.2011, ndryshuar nga Shkolla e Lartë Universitare Jopublike "Universiteti European i Tiranës, në "Universiteti European i Tiranës. Ky institucion i është nënshtruar procesit të vlerësimit të jashtëm institucional, proces i finalizuar me Vendimin e Bordit të Akreditimit, Nr. 12, datë 07.04.2017 "Për akreditimin periodik të Institucionit të Arsimit të Lartë "Universiteti European i Tiranës" duke u vlerësuar lidhur me shkallën e vlerësimit të standardeve me cilësimin "i përbush plotësisht .

Vlerësimi i GVJ për cilësinë akademike të UET dhe vendimi përfundimtar i Bordit të Akreditimit, ishte pozitiv. Veprimtaria e institucionit mbështetet në Statutin e hartuar e përditësuar sipas ligjit për arsimin e lartë dhe është miratuar me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Sportit Nr. 90, datë 28.02.2017 "Për miratimin e statutit të Universitetit European të Tiranës". Programi i studimit "Master i Shkencave" në "Financë Bankë me profile Banka dhe Tregje Financiare dhe Ekonomi Finance" ofruar nga Universiteti European i Tiranës" u licensua me VKM, Nr. 74 , datë. 21/01/2009.

Programi i Studimit aktualisht ofrohet nga Departamenti i Financës dhe Ekonomiksit, Fakulteti Ekonomik dhe i Teknologjisë së Informacionit. Në përfundim të mbrojtjes së diplomës, studenti fiton titullin "Master i Shkencave" në "Financë Bankë me profile Banka dhe Tregje Financiare dhe Ekonomi Finance". Programi i studimit është akredituar për herë të parë me Urdhër të MAS nr. 68, datë 14.02.2011 në përputhje me Vendimin nr. 133 datë 21.10.2010, të Këshillit të Akreditimit me vlerësim pozitiv me disa rekomandime.

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)


Grupi i vlerësimit të jashtëm përbëhet nga:

Prof. Dr. Halit Xafa

Prof. Dr. Drini Salko.

Menaxhere vlerësimi e kësaj procedure është specialistja e ASCAL Znj. Majlinda Demirneli.

Më datë 15.05.2018 me shkresë zyrtare me Nr. 25/35 Prot me lëndë:" Dërgohet Draft Raporti i Vlerësimit të Jashtëm", UET është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm. UET përcjell në ASCAL nëpërmjet sistemit, datë 21.05.2018 komentet në lidhje me Draft – Raportin e Vlerësimit të Jashtëm. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm pasi lexoi me kujdes përgjigjen e UET, paraqiti argumentimin për secilin nga komentet dhe vendosi: të marrë në konsideratë dhe të reflektojë pjesërisht ndryshimet në RVJ për komentin 1 (fq. 1 të objeksjoneve); të marrë në konsideratë dhe të reflektojë ndryshimet në RVJ për komentin 2 (fq. 2 të objeksjoneve). të marrë në konsideratë dhe të reflektojë ndryshimet në RVJ dhe për komentin 4 (fq. 4 të objeksjoneve). Pas reflektimit të komenteve nga 11 rubrika të vlerësuara në 8 prej tyre standardet plotesohen plotësisht dhe në 3 të tjerat standardet plotesohen kryesisht.



ANALİZË PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA KA NË VENDIMIN PËR AKKREDITIMIN E PARË

I. Rekomandimet e Këshillit të Akreditimit

Nga Vlerësimi i Jashtëm viti 2010 dhe Këshilli i Akreditimit për këtë program studimi janë bërë këto rekondime:

- a. Fakulteti/departamenti duhet të shoh me përparësi përfshirjen e stafit të brendshëm në organizimin e këtij programi studimi sepse shikohet shpesh një numur i madh i pedagogëve të jashtëm dhe jo rallë here i njëjtë pedagog është i përfshirë në më shumë se dy lëndë brënda të njëjtit program studimi
- b. Ka syllabluse që duhet të ishin në përputhje me objektivat dhe përbajtjen e programit. kështu flitet për nivele të avancuara studimi por në fakt literatura e përmendur apo edhe tema apo çështje të vecantana në to nuk përputhen me nivelin që synohet të arrihet në përgatitjen e studentit. Gjithashtu ka dhe përsëritje të literaturës në disa syllabuse. Vec këtyre të njëjtat kurse zhvillohen në cikle të ndryshme studimi psh një lëndë e DND zhvillohet me të njëtin syllabus në një program studimi MNP.
- c. Të aplikohen procedura të qarta dhe ndonjë kriter pranimi në këtë nivel të dytë studimi në mënyrë që të rritet cilësia jo vetëm e studentëve por dhe e mësimdhënies.
- d. Problem shfaq literatura në gjuhë të huaj përdorimi i së cilës praktikisht është i vështirë për shkak të mundësisë dhe disponibilitetit të bibliotekës për të ofruar këto tituj në gjuhë të huaj, si dhe me mundësinë dhe njohjen e gjuhës së huaj nga vetë studentët. Kjo do të kërkonte një plan konkret nga ana e Universitetit për pajisjen e studentëve me titujt e domosdoshëm të teksteve si dhe aplikimin e përvojës positive që ekziston në nivelin bachelor për përkthime apo përshtatje në gjuhën shqipe të tyre.

II. Plotësimi i tyre nga Institucioni

- a. Kjo dukuri është zbutur duke rritur numrin e pedagogëve të brëndshëm me tituj e grada(Shih Tabela 2 Aneksi), bile edhe në stafin e jashtëm ka prezencë pedagogësh të ftuar me tituj e grada. Sidoqoftë numuri i kufizuar i pedagogëve për shkak edhe të numrit të studentëve dhe llojshmërisë së disiplinave ka kushtëzuar mbulimin nga një pedagog të dy disiplinave në të njëjtin program pa llogaritur edhe përshirjen në bachelor, ndërsa ngarkesa më tepër është ulur ndjeshëm. **Ky rekondim është plotësuar plotësish.**
- b. Situata me syllabuset paraqitet e përmirësuar në krahasim me akreditimin e parë si në drejtim të strukturimit, përbajtjes, rjedhës logjike të temave, literaturës së përfshirë. Mbetet të rishikohen në vazhdimësi përsëritje të temave, pjesa aplikative e zhvillimit në auditor duke rritur cilësinë edhe të rasteve studimore e aplikimeve praktike,etj. **Ky rekondim është plotësuar plotësish**
- c. Lidhur me këtë rekondim për studentët, si dhe mbështetur në analizën swot të bërë në vlerësimin e viti 2010, nga verifikimi në institucion rezulton se tashmë ka një kriter pranimi, nota mesatare e cila ndonse në gjykimin tonë është ende relativisht e ulët ka frenuar disi ardhjen e kontigjenteve të dobta dhe në cilësinë e pranimeve dhe atë të mësimdhënies. Per nje hyrje me cilesore te studenteve ne kete program UET ka si kriter ne momentin e regjistrimit edhe dorezimin e certificates se mbrojtjes se gjuhes se huaj. **Ky rekondim është plotësuar plotësish**
- d. Rekomandim dhe mangësi në analizën swot ishte mungesa e titujve në gjuhën e huaj. UET është angazhuar vitet e fundit në një program përkthimesh të disa teksteve bashkëkohorë të autorëve më të njohur në botë në fushën e financë bankës gjë që e ka përmirësuar shumë këtë situatë. **Ky rekondim është plotësuar plotësish**

1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

Terma reference: Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, strategjitet afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshtatja e objektivave dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për IAL.

Raporti vlerësimit të jashtëm është hartuar në përputhje me standartet e caktuara nga ASCAL, rubrikat dhe kriteret përkatëse, duke harmonizuar pjesën përshkrimore me atë të shkallës së plotësimit të standardeve. Ky raport ka për detyrë verifikimin e shkallës së plotësimit të rekomandimeve të bëra në Akreditimin e parë dhe vlerësimin e shkallës dhe cilësisë së plotësimit të standardeve duke dhënë edhe komentet dhe rekomandimet përkatëse. Detyrë e grupit të ekspertëve është riakreditimi i programit master shkencor në Financë Bankë me profilet Banka dhe Tregjet Financiare dhe Ekonomi-Financë Ky program ofrohet në Fakultetin Ekonomik dhe të Teknologjisë së Infomacionit. Ai është licensuar me VKM Nr. 74 datë 21.01.2009. Ky program mbështetet në parimet e Kartës së Bolonjës, ka kohëzgjatje normale dy vite studimi, me 120 ECTS. Programi ofron diplomën e ciklit të dytë të studimeve. Msc Financë Bankë, bazuar në strategjinë e UET për një formim shkencor bashkëkohor, me tekste bazë mësimore nga autorë të njojur te huaj të fushës dhe vendas. Ai synon ndërthurjen e lendëve bazë të formimit teorik me ato aplikative. Programi synon tregun e punës dhe forcimit të lidhjeve me biznesin, që të diplomuarit t'i përgjigjen nevojave aktuale të ekonomisë së vendit tonë. Të diplomuarit e këtij programi kanë mundësinë të vazhdojnë studimet e ciklit të tretë të doktoratës. Ky program studimi është akredituar për herë të parë me urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 68, datë 14.02.2011.

Sipas RVB, programi i studimit Master i Shkencave synon ta pajisë studentin me:

- a. Thellim, zgjerim dhe specializim të koncepteve;
- b. Parapërgatitje për licencën e profesionit të rregulluar;
- c. Formim tematik dhe jopanoramik apo historik;
- d. Aftësi për kërkim të avancuar, të pavarur shkencor;
- e. Përvetësim i literaturës kryesore të fushës së studimit;
- f. Stazhe, internship në kompani ose te punëdhënësit më të mëdhenj;
- g. Aftësim i plotë për zhvillim karriere, si dhe për vazhdimin e studimeve të doktoratës.
- h. Diplomë me originalitet, me karakter teorik ose empirik, produkt krijues i studentit.

Spas RVB ,programi synon si mundësi punesimi ministritë dhe institucionet e tjera qendrore, bashkitë e komunat, specialistë e drejtues të bankave, shoqërive të sigurimit apo institucioneve financiare si: drejtoritë ekonomike, buxhetit, investimeve, studimeve e analizave ekonomiko-financiare, integrimit evropian, politika monetare, mbikëqyrje bankare, operacionet monetare, shërbime të ndryshme bankare për klientët, sistemi leasing, marketingu bankar dhe sigurimeve, sistemi i tatimeve dhe taksave, doganave, organe shtypi e media të specializuara në sferën financiare, bankave, etj.

Gjykojmë se ky objektiv shtuar edhe bizneset private, kërkon forcimin e profileve, moduleve, dhe prani më shumë të lëndëve me zgjedhje.

Programi është ndërtuar duke mbështetur misionin e UET për një edukim cilësor dhe forcimit të dijeve të qëndrueshme. Ai kombinon teorinë dhe praktikën duke synuar nxitjen e studentëve për përvetësimin e dijeve bashkëkohore. Programi i studimit mbështetet nga një staf akademik cilësor Ai mbështetet nga një infrastrukturë cilësore në procesin e mësimdhënies dhe në mqediset e tjera mbështetëse.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve ¹
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e	

tij.

Kriteri 3 Programet e studimeve hartohen në përputhje me misionin dhe qëllimin e institucionit;

Kriteri 4 Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;

Kriteri 5 Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit;

Kriteri 6 Programet e studimeve pasqyrojnë vullnetin e institucionit për ruajtjen e vlerave kulturore të kombit.

Në hartimin e programit të studimit Mcs në Financë Bankë me profile, vihet re se ai ka synuar fushën e sistemit financiar e bankar, dhe administratën qëndrore, pa përashtuar edhe biznesin privat. Në zbatimin dhe implementimin e tij janë angazhuar kryesisht departamenti i Ekonomiksits dhe Financës.

Gjykojmë se tregu i punës është shumë më i gjërë se institucionet bankare, ato të sigurimeve dhe administrative publike, janë bizneset private, që në gjykimin tone nuk janë të reflektuara sa dhe si duhet në program

Nga akreditimi i pare ka përpjekje dhe hapa për përmirësimin e kurikulave. Duke vlerësuar hapjen e UET me biznesin privat në drejtim të kualifikimeve, konsulencave, përgjegjësive sociale dhe praktikave, në kuadrin e një projekti të iniciuar së fundmi të quajtur, *vlerësojmë se kurrikula e programit është e orientuar thuajse në sistemin financiar dhe bankar dhe brenda ketij orientimi predominojnë lëndët e formimit të përgjithshëm e profesional në këto fusha dhe thuajse mungojnë lëndët dhe disiplinat tradicionale të formimit në biznese prodhuese, sherbimesh etj.* Disiplina të tilla si menaxhimi financiar, kontabiliteti financiar, i kostos dhe drejtimeve, apo edhe të auditimit e analizës financiare, taksimi i biznesit, kontabiliteti bankar nuk janë të përfshira në program duke i dhënë njëanshmëri në drejtim të orientimit më gjithëpërfshirës ndaj tregut. E njëjtë gjë duhet thënë edhe për administrimin publik, si menaxhimi publik, menaxhimi financiar i institacioneve publike, etj, duke e afruar më shumë me tregun e ministreve dhe institacioneve qëndrore jo banka,

Në të njëjtën kohë ka mbivendosje në lëndë si tregjet dhe institucionet financiare, Tregu bankar dhe institucionet e tij, kur dihet shkalla dhe niveli i zhvillimit të tyre modest në vendin tonë, Banka qëndrore dhe politikat monetare, etj apo edhe në lëndë të formimit të përgjithshëm si makroekonomi e avancuar, mikroekonomi e avancuar kur mund të ishin në një lëndë ekonomiks apo ekonomiks manaxherial dhe ekonomiksi i BE apo kontabiliteti nacional që duke u krahasuar me objektivat e punësimit është komoditet në këtë nivel studimi.

(shih **Tabela 7**) Programi i studimit nuk bie ndesh me interesat kombëtare dhe cënimin e vlerave kulturore të vendit.

Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.

<p>Kriteri 1 Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;</p>	<p>Programi i studimit Msc në Financë Bankë me profile në krahasin me akreditimin e pare ka ardhur duke u konsoliduar dhe stabilizuar nga pikpamja cilësore forma, përbajja dhe niveli implementimit të programit. Ky program si për degën edhe për profilet që mbulon ka patur si synim mbështetjen e strategjisë dhe misionit të UET. Gjykojmë se komentet e bëra në standartin I.1 duhet te reflektohen në përmirësimet e ardhshme dhe përputhjen e programeve me strategjinë.</p>
<p>Standardi I.3 - Programet e studimeve ofrohen në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	
<p>Kriteri 1 Përbatja e programeve të studimeve është në përputhje me kriteret e përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi;</p> <p>Kriteri 2 Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me nivelin e kualifikimit të arritur dhe të përcaktuar nga Korniza Shqiptare e Kualifikimit.</p>	<p>Programi bazohet tashmë në Kartën e Bolonjës që përcakton ndarjen e grupimit të lëndëve në kurrikulen e programit Msc në Financë Bankë, në përputhje me standarde dhe praktikat më të mira bashkëkohore Nga vizita në institucion, konstatuan se syllabuset janë hartuar me rubrikat e nevojshme si objektivat e lëndës, parametrat kryesore të mësimdhënies dhe mësiminxenies, cështjet kryesore, literatura, detyrimet gjatë vitit dhe ato përfundimtare, etj, Programi në tërësi, krahas objektivave ka të specifikuara kreditet për cdo lëndë, si dhe praktikën mësimore apo punimin e e diplomës duke synuar objektivat e programit dhe formimit. Hartimi i programit është bërë sipas kërkesave të përcaktuara nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p>
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një plan zhvillimi të programeve të studimeve, të rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënëtit.</p>	<p>Programi i studimit “Master i Shkencave” në “Financë Bankë me profile Banka dhe Tregje Financiare dhe Ekonomi Financë” ofruar nga Universiteti Europian i Tiranës” u licensua me VKM, Nr. 74 , datë. 21/01/2009.</p> <p>Programi ofron 120 kredite, me dy vite akademike nga 60 kredite në vit, me tre simestra proces mesimore dhe simestrin e fundit praktika mesimore dhe diploma. Emërtimi i programit të studimit është në përputhje me orientimet e Kornizës Shqiptare të Kualifikimit. Msc është program në ciklin e dytë.</p>
<p>Kriteri 1 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për zhvillimin dhe përmirësimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni harton një plan strategjik në nivel institucioni për përmirësimin e rezultateve të mësimdhënies dhe të të nxënëtit.</p>	<p>Referuar RVB dhe vizitës në institucion UET ka hartuar planin e tij strategjik 2015-2020 duke përfshirë në të edhe përmirësimin e programeve të studimeve, nëpërmjet rishikimit të tyre periodik së paku një herë në dy vjet. Ky është një objektiv që nga grapi RVJ rekandohet të zbatohet fort dhe në fryshtë e tregut që kërkon të mbulojë në fushën financë bankë që përfshin institucionet e përmëndura në pjesën përshkruese dhe duke ndjekur zhvillimet në kurikulat bashkëkohore perëndimore.</p> <p>Referuar RVB dhe vizitës në institucion ,UET ka angazhuar ekspertë të jashtëm për të vlerësuar</p>

	<p>cilësinë e mësimdhënies. Vlerësojmë angazhimin e ekspertëve të jashtëm, për të rritur cilësinë e programeve të studimit UET, cilësinë e hartimit të sylabuseve dhe të mësimdhënies. Për ilustrim në tabelën 9 janë paraqitur disa ndryshime që gjykojmë se duhet të pasohen në fryshtë e rekomandimit për këtë standart. Ndryshimet sipas opinionit tonë janë të justifikuara dhe respektojnë përqindjet e lejuara të ndryshimeve në program sipas dispozitave në fuqi. Pa përsëritur ndryshimet duhet të synojnë më mire dhe të optimizohen në funksion të faktit, kujt i drejtohet programi, tregut të punës, fleksibilitetit në lëndët me zgjedhje, rritjes se pjesës aplikative, pra lipset të bëhen përsëri, etj.</p>
Konkluzionet e vlerësimit:	

Bazuar në RVB si dhe vizitën në institucion dhe dokumentet shtesë të përfshitura gjatë vizitës, GVJ vlerëson se programi i studimit "Msc në Financë Bankë me profile" është synuar të hartohej në përpunje dhe në mbështetje të strategjisë së zhvillimit si në aspektin sasior ashtu edhe cilësor. Vlerësojmë se kurrikula e programit është e orientuar thuajse në sistemin financiar dhe bankar dhe brenda ketij orientimi predominojnë lëndë e formimit të përgjithshëm e profesional në këto fusha dhe thuajse mungojnë lëndët dhe disiplinat tradicionale të formimit në biznese prodhuase, sherbimesh etj. Disiplina të tillë si menaxhimi financiar, kontabiliteti financiar i kostos dhe drejtimit, apo edhe të auditimit e analizës financiare, taksimi i biznesit, kontabiliteti bankar nuk janë të përfshira në program duke i dhënë njëanshmëri në drejtim të orientimit më gjithëpërfshirës ndaj tregut. E njëjtë gjë duhet thënë edhe për administrimin publik, si menaxhimi publik, menaxhimi financiar i institucioneve publike, taksimi, etj, duke e afruar më shumë me tregun e ministrive dhe institucioneve qëndrore jo banka

GVJ mbështetur në RVB, dokumentacionin shoqëruar të dosjes së vetylerësimit të institucionit konkludon se ky program lidhur me misionin dhe objektivat e institucionit si dhe procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies i plotëson standardet plotësisht

2. Struktura akademike e Fakultetit (përgjegjës për programin e studimit)

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Strukturat akademike të Fakultetit, ndarja në Departamente, të dhëna për ndarjen e personelit në këto njësi bazë, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE), Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ (PA), koordinimi i mësimdhënies me njësi të tjera.

Universiteti Europian i Tiranës përbëhet nga strukturat akademike dhe administrative. Aktualisht, UET-i përbëhet nga tre fakultete: Fakulteti i Shkencave Sociale dhe Edukimit, Fakulteti Juridik dhe Fakulteti Ekonomik dhe i Teknologjisë së Informacionit, të strukturuar në njësi bazë (departamente dhe qendra). Fakulteti në vitin aktual akademik 2017-2018 ka në përbërjen e tij 82 personel akademik efektiv dhe me kontratë. Personel Akademik Efektiv (PAE) janë gjithsej 52 persona, nga të cilët 29 janë me tituj/grada, ndërsa Personel Akademik me Kontratë (PAK) janë gjithsej 30, nga të cilët 19 me tituj/grada. Duke vezguar evoluimin e përbërjes sipas viteve konstatojmë se është rritur numuri i PAE me grada e tituj nga viti në vit. Në tabelën nr.1 jepen të dhëna më të detajuara.

Krahas ciklit të parë, Fakulteti Ekonomik dhe i Teknologjisë së Informacionit ofron 3 programe studimi të Ciklit të Dytë Master i Shkencave (MSH), 5 programe të Ciklit të Dytë Master Profesional (MP) dhe 1 program të Ciklit të Tretë (Doktoraturë). Sipas statistikave të vitit 2016-2017, Fakulteti Ekonomik dhe i Teknologjisë së Informacionit pranon rrëth 54.5% e studentëve të programeve Bachelor, rrëth 53.4% e studentëve në programet Master i Shkencave dhe 71% e studentëve të UET. Fakultetit Ekonomik dhe i Teknologjisë së Informacionit është dhe fakulteti kryesor i UET-së ku ndjekin studimet rrëth 55% e

numrit të studentëve të institucionit. Nga akreditimi i parë Fakulteti dhe Departamentet kanë pësuar ndryshime që kanë synuar lidhjen më të mirë të programeve të studimit, të diplomave që ofrohen me mënyrën e organizimit të tyre, me synim rritjen e cilësisë dhe përshtatjen me kërkesat e tregut.

Fakulteti Ekonomik dhe i Teknologjisë së Informacionit përbëhet nga tre Departamente:

- Departamenti i Financës dhe Ekonomiksit
- Departamenti i Menaxhimit dhe Marketingut
- Departamenti i Informatikës, Matematikës dhe Statistikës.

Departamentet janë të organizuara me grup lëndë, në varësi të afërsisë së disiplinave. Struktura dhe përbërja e departamenteve ka ardhur duke u konsoliduar në funksion të shërbimeve akademike dhe shkencore që ato ofrojnë.

Gjykojmë se struktura akademike e departamentit është konceptuar në funksion të disiplinave që mbulon në sistemet bachelor dhe master.

Departamenti i Financës dhe Ekonomiksit si njësia që mbulon këtë program ka patur ecurinë e zhvillimeve sasiore dhe cilësore që përmendëm më lart dhe që shprehet në të dhënat si si më poshtë:

Për vitin akademik 2014-2015 Departamenti përbëhet nga **9 (PAE) 8** me tituj/grada, dhe **18 (PAK)** nga **ku 9** me tituj/grada.

Për vitin akademik 2015-2016 Departamenti përbëhet nga **25 (PAE) 15** me tituj/grada, dhe **10 (PAK) 5** me tituj/grada.

Për vitin akademik 2016-2017 Departamenti përbëhet nga **22 (PAE) 13** me tituj/grada, dhe **10 (PAK) 8** me tituj/grada.

Për vitin akademik 2017-2018 Departamenti përbëhet nga **23 (PAE) 14** me tituj/grada, dhe **3 (PAK) 1** me tituj/grada.

Për ilustrim në 2016-2017 janë 3 Prof.Dr, 6 Prof.As, 3 Dr, 2 Dr në process dhe 7 Msc.

Për vitin 2017-2018 nga 23 staf PAE, janë 3 Prof.Dr, 5 Prof.As, 2 PhD, 4 Dr, 1 Dr. në process dhe 8 Msc. Pra departamenti po konsolidohet në aspektin sasior dhe cilësor, c'ka përbën mundësi për avansim në mësimdhënie cilësore dhe programe ambicioze në funksion të kërkesave të tregut

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Gjatë vizitës në institucion nga ana e GVJ u kërkua, në takimet me strukturat drejtuese të institucionit, personelin e Departamentit të Financës dhe Ekonomiksit të dhëna shtesë dhe të fundit lidhur me evolucionin e stafit të këtij departamenti. Gjithashtu GVJ u njoh edhe me procedurat e rolit të Departamentit në procesin e hartimit të programeve mësimore, kurrikulave, rekrutimit të personelit akademik gjatë vizitës në institucion etj. Të dhëna më të detajuara gjenden tek ankeset e ketij rapporti shih tabelat 1 dhe 2.

(Të dhënat jepen në **Tabelat 1,2 në Aneks**)

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.2 - Institucioni organizohet në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për përbushjen e misionit të tij.	
Kriteri 1 Institucioni organizohet në mënë që të përbushë misionin e tij;	Misioni dhe strategjia afat gjatë është mbështetur me ngritjen e strukturave në shkallë universiteti dhe fakultetesh. UET është i organizuar në 3 Fakultete a. Fakulteti Ekonomik dhe Teknologjisë së Informacionit b. Fakulteti i Shkencave Sociale dhe Edukimit c. Fakulteti Juridik
Kriteri 2 Institucioni ka së paku dy Fakultete;	
Kriteri 3 Fakulteti organizohet në njësi bazë. Çdo fakultet ka, së paku, tri të tillë, nga të cilat dy departamente;	
Kriteri 4 Fakulteti ose Instituti i Kërkimit dhe Zhvillimit përbëhet nga, së paku, 3 njësi bazë me	duke përbushur standartin e kërkuar.

<p>objektiva dhe mision të mirëpërcaktuar;</p> <p>Kriteri 5 Departamenti duhet të ketë në përbërje të tij të paktën 7 anëtarë efektivë si personel akademik, ndër të cilët të paktën 3 duhet të jenë me gradën shkencore "Doktor".</p>	<p>Fakulteti Ekonomik dhe i IT dhe Fakulteti i Shkencave Sociale janë të organizuara në 3 Departamente. Fakulteti Juridik përbëhet nga 2 Departamente dhe 1 Qendër kërkimore.</p> <p>Personeli akademik i njësive bazë mbulon nevojat jo vetëm të fakultetit por edhe ato të fakulteteve të tjera për disiplina që zhvillohen në to. Fakulteti në vitin aktual akademik 2017-2018 ka në përbërjen e tij 52 personel akademik efektiv (PAE) nga të cilët 29 janë me tituj/grada. Nga këto Departamenti i Financës ka 23 anëtarë gjithsej dhe 14 me tituj e grada, pra rrëth gjysma e stafit të fakultetit.</p>
<p>Standardi II.3 - Njësitë e institucionit angazhohen drejtpërdrejt dhe me përkushtim për realizimin e programeve të studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Njësitë bazë dhe kryesore janë të ndërgjegjshme për përgjegjësitë që kanë për realizimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Njësitë bazë dhe kryesore përfshihen në procesin e rekrutimit të personelit akademik të nevojshëm dhe në vlerësimin e tij.</p>	<p>Departamenti sipas ligjit të Arsimit të Lartë është njësia bazë</p> <p>Ligi, Statuti i UET dhe dokumenti "F.V. Mbi organizimin dhe funksionimin e Departamentit" si pjesë e broshurës së dokumenteve UET kanë përcaktuar funksionet kryesore të Departamentit, element të pavarësisë së tij akademike, si shqyrtimin dhe miratimin e planeve mësimore, programeve të lëndëve (syllabuseve), si edhe propozimin e ndryshimeve tekstet mësimore që rekomandohen realizimin e programit nga pikpamja sasiore e cilësore.</p> <p>Departamenti mbulon problematika të tilla si: shqyrtimin dhe miratimin e planeve mësimore, programeve të lëndëve (syllabuseve), propozimin e ndryshimeve; shqyrtimin dhe miratimin e propozimeve të gruplëndëve për tekstet mësimore në lëndët e programit të studimit; ndjekjen e realizimit të programit të studimit dhe mbikëqyrjen e cilësisë së mësimdhënieve.</p> <p>Kërkosat per staf të ri behen nga departamentet sipas programeve që ofrohen dhe kontigjenteve që vijnë në to duke patur parasysh edhe normat mësimore për stafin efektiv të punësuar. Departamenti propozon kërkosat e reja, Përgjegjësi i departamentit është pjesë e komisionit të rekrutimit të personelit të ri akademik. Përsa i përket performances akademike, ajo është ndjekur në disa mënyra.</p>



Konkluzionet e vlerësimit:

Fakulteti Ekonomik dhe i Teknologjisë së Informacionit është organizuar në mbështetje të akteve ligjore në fuqi dhe ka synuar realizimin e objektivave të institucionit. Departamenti i Financës dhe Ekonomiksit është njësia bazë për programin Msc Financë-Bankë. Edhe ajo ka respektuar nga pikpamja e ndërtimit dhe funksionimit aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi

Departamenti i Financës dhe Ekonomiksit është organizuar në mbështetje dhe në përbushje të misionit të tij caktuar në strategji dhe statut, për të ofruar me cilësi programet e studimit në të 3 ciklet e studimit (Bachelor, Master dhe Doktorat). Departamenti drejtton, menaxhon dhe përditëson realizimin sasior dhe cilësor të programit të studimit dhe ka detyra e funksione të përcaktuara qartë në aktet rregullatore të institucionit. Departamenti dhe Përgjegjësi i tij përfshihen në propozimin dhe rekrutimin e personelit akademik të njësisë së tij, dhe në vlerësimin periodik të performancës të personelit akademik të njësisë.

Rekomandojmë ndryshimin e emrit të Departamentit nga i Financës dhe Ekonomiksit në i Ekonomiksit dhe Financës, dhe në varësi të kontigjenteve të ardhshme dhe përsosjeve të shihet mundësia e krijimit në vehte të Departamentit të Ekonomiksit si department me prani mësimdhënie dhe syllabusesh në të gjitha programet që ofron Fakulteti Ekonomik dhe IT, kjo, duke respektuar numrin e PAE për cdo department dhe ata me tituj e grada sipas dispozitave ligjore përkatëse.

GVJ vlerëson pavarësish rekonditimit të mësipërm për ndryshimin e emrit apo edhe krijimin e departamentit te ekonomiksit ne vehte që eshte problem evoluimi, por edhe kostosh, Struktura e Fakultetit te Ekonomise dhe Teknologjise se Informacionit dhe Departamenti i Finances dhe Ekonomiksit si njesi që mbulon këtë program **i plotëson standaret plotësish për arritjen e misjonit dhe objektivat e programit.**

3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: Të dhëna për kualifikimin e Personelit akademik, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ (PA), raporti PAE/PAK, raportet: Personel akademik/Personel administrativ/student; nevojat për Personel akademik/ administrativ, shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik, marrëdhëniet me strukturat e tjera jashtë kohës së punësimit, kriteret e rekrutimit të personelit akademik, etj.

Personeli akademik dhe mbështetës

Sipas statutit të UET dhe kontratave individuale, personeli akademik dhe drejtuesit akademikë kryejnë veprimtari të mësimdhënieve, të kërkimit shkencor ose të aplikuar, shërbime për zhvillimin e UET-it, këshillim për studentët, tutoriat dhe detyra administrative. Të gjithë keta elementë janë përcaktuar në kontratë sipas të cilave pagesa është 60 % për punën mësimore dhe 40 % për punën shkencore. Përzgjedhja e anëtarëve të personelit akademik, si dhe vlerësimi i performancës së tyre rregullohet me dispozitat përkatëse në Statutin e UET-it dhe me dokument të vecantë. Emërimi i tyre është e drejtë eskluzive e Rektorit. Të drejtat dhe detyrat e personelit akademik ngarkesa dhe format e saj përcaktohen në kontratën e lidhur mes tij dhe UET-it, bazuar në Kodin e Punës, në Statutin e institucionit, në rregulloret, në Kodin e Etikës si dhe në dokumenta të tjera të miratuara nga organet drejtuese të UET-it. Vlerësimi i performancës së stafit për mësimdhëni ka në bazë raportin e vlerësimit të brendshëm të cilësisë së UET, si dhe përpunimin e pyetesorëve të studentëve që plotësohet periodikisht cdo fund semestri.

Personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi përbëhet nga ai i punësuar me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme. Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë lidh kontratë me afat ose pa afat. Në PAE përfshihen drejtuesit, personeli akademik i brendshëm dhe pedagogët senior, në PAK përfshihen personeli akademik i jashtëm, pedagogët senior dhe lektorët e ftuar. Departamentet propozojnë nevojat për rekrutim me kohë të plotë dhe të pjesëshme mbështetur në nevojat e auditorit,

kapacitetet ekzistuese, normat mësimore, fushat e kualifikimit dhe ekspertizës, nevojat për rritjen cilësore të mësimdhënies, dhe profiling professional dhe akademik të të propozuarit.

Kriteret kryesore mbi të cilat është mbështetur vlerësimi dhe rekrutimi janë të tilla si :

- Përvoja në mësimdhënie në nivel universitar;
- Grada shkencore Doktor ose PHD, titujt Akademik Profesor, Profesor i Asociuar;
- Cilësia dhe standartet e universitetit ku është diplomuar kandidati, duke rritur prezencën edhe të kandidatëve të shkolluar në universitetet perëndimore;
- Rezultatet e kandidatit, aktivitetin e tij botues dhe shkencor, aftesinë komunikuese, objektivat shkencore të UET, intervista e tij nga komisioni i posaçëm i rekrutimit dhe leksioni i hapur para Departamentit përkatës (kur aplikohet) ndonse kjo e fundit nuk ka qënë praktikë e rregullt për cdo pedagog efektiv apo me kohë të pjesëshme.
- Zotërimi i gjuhëve të huaja

Janë punësuar edhe pedagogë pa tituj e grada, por me përvojë në profesion. në lëndë me karakter praktik, cikle leksionesh e seminaresh. Në kontratën e lidhur janë përfshirë të drejtat, detyrimet, ngarkesa në auditor, bazuar në Kodin e Punës, në Statutin e UET-it, në rregulloret, në Kodin e Etikës dhe në Kodin e Integrititet Akademik.

Plani mësimor është planifikuar të realizohet për disiplinat bazë formuese, ato të drejtimit të programit dhe ato të profilit me staf të kualifikuar me tituj e grada. Në të janë përfshirë lendët që ofrohen, praktika mësimore, tema e diplomës dhe kreditet përkatëse. Rekomandojmë që të shihet mundësia e diferençimit të krediteve, pavarësisht vështirësive organizative apo të planifikimit të stafit që sjell, të shihet edhe mundësia e moduleve me kredite të diferençuara, gje që rrit fleksibilitetin, thekson diferençat midis profileve dhe justifikon dhe afron ne auditor personalitetet shkencore dhe akademike brenda dhe jashtë universitetit, brënda dhe jashtë vendit. Eshtë ruajtur një raport kreditesh 12 kredite disiplina të formimit të përgjithshëm, 42 kredite në formimin karakterizues, 12 kredite në disiplina të ngjashme ose integruese, realisht të profilit, 6 kredite në disiplina me zgjedhje, 12 kredite praktika dhe 36 kredite diploma.

(Shih Tabela 8 ne Anekset)

Programi Msc Financë Bankë është mbuluar nga staf me tituj e grada shkencore dhe ka ardhur duke u konsoliduar nga viti në vit. Nga viti në vit është rritur dhe stabilizuar numuri dhe kualifikimi i stafit efektiv dhe me kohë të pjesëshme ndonse edhe ndryshimet nga viti në vit janë relativisht të dukshme pavarësisht nga arsyet apo motivet e lëvizjeve cka gjykojmë se duhet stabilizuar.

Duke vëzhguar përbërjen e stafit sipas viteve në staf të brëndshëm dhe të jashtëm, dhe staf me tituj dhe grada dhe pa tituj e grada, vihen re dy dukuri: Nga viti në vit është synuar të rritet numuri i PAE ndaj atij PAK dhe në vitet e fundit, PAK ka arritur në nivele të papërfillshme.

Kështu sipas viteve duke përpunuuar të dhënat e tabelave 3 në Aneks kemi:

Viti akademik	PAE(për program studimi)	PAK(për program studimi)
2011-2012	7	4
2012-2013	9	5
2013-2014	10	4
2014-2015	12	1
2015-2016	14	1
2016-2017	14	1
2017-2018	17	2

Ndërkohë duke gjykuar kualifikimin e stafit akademik efektiv të programit të studimit kemi:

Viti akademik	Prof.Dr	Prof As	Dr/ PhD	Msc
2011-2012	1	1	5	0
2012-2013	2	1	5	1
2013-2014	3	2	2	3
2014-2015	3	3	3	3
2015-2016	4	5	3	2
2016-2017	3	6	1	4

2017-2018	4	5	4	4
-----------	---	---	---	---

Sic shihet ka ardhur duke u rritur numuri PAE nga viti në vit dhe është ulur ai PAK dhe ndërkokë vihet re rritje e numurit të PAE me tituj professor dhe professor i asociuar ndërkokë që ka mbetur në një numur të vogël ai i stafit pa tituj e grada. Gjykojme se ky është një raport i pranueshem dhe funksional

Raporti Personel Akademik/Student në këtë program per vitin akademik aktual është **19/205**, ndërsa për vitin akademik 2016-2017 është **15/205**

Raporti Personel Administrativ / Student në këtë program per vitin akademik aktual është **52/205**
Personeli administrativ është dhënë në nivel institucional pasi i shërben gjithë programeve të studimit

Raporti PAE/PAK në këtë program per vitin akademik aktual është **17/2**, ndersa per vitin akademik 2016-2017 eshte **14/1**

Raporti PAE/Totalit te personelit akademik në këtë program per vitin akademik aktual është **17/19 = 90 %**, ndersa per vitin akademik 2016-2017 eshte **14/15 = 93%**

Bazuar në raportet e mësipërme, vihet re ky program për vitin akademik aktual mbulohet rreth **90 %** nga **staf i brendshëm PAE** dhe rreth **10% staf i jashtëm, PAK**.

Vlerësimi i treguesve të matshëm:

- Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat, të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre (**referohu tabelave nr.3 në Aneks, të cilat janë plotësuar edhe nga verifikimi i tabelave në RVB**)

Personelit akademik efektiv (PAE) dhe personeli akademik me kontratë (PAK) janë në përputhje me dispozitat ligjore për organizimin e strukturave didaktike për programet e studimit.

Sipas dokumentacionit të paraqitur për vitin akademik 2017-2018, stafi akademik që është angazhuar në këtë program studimi përbëhet nga **19 pedagogë** gjithsej, nga të cilët **17** janë personel akademik efektiv (PAE), dhe **2** personel akademik me kontratë (PAK). Shihet prirja drejt mbulimit të procesit mësimor në këtë program me staf akademik efektiv PAE.

- Këshilli Shkencor i Programit të studimit dhe Koordinatori/ët e programit të studimit**

Këshilli Shkencor i Programit të studimit sipas RVB dhe verifikimit të vizitës në institucion përbëhet nga **4** anëtarë dhe koordinatori i programit të studimit.

(Tabela nr 4 në Aneks).

- Të dhënat sipas sektit dhe sipas moshës së personelit jepen (Tabela 5 në Aneks)** –

Lidhur me ndarjen sipas gjinive duke përpunuuar të dhënat për fakultetin e ekonomisë dhe IT sipas gjinive sipas viteve kemi (PAE dhe PAK së bashku):

Viti akademik	Staf Total(PAE+PAK)	Nga këto Femra	Perqindja femra/total
2014-2015	27	16	59
2015-2016	35	16	46
2016-2017	32	16	50
2017-2018	26	17	65



Nëse analizohet mosha e PAE, PAK dhe stafit administrativ për vitin 2016-2017 sipas RVB, vihet re se dominon intervali nga 25 vjec në 45 vjec dhe kjo kryesisht në stafin administrativ dhe ndihmes, ndërsa persa i përket stafit PAE dhe PAK dominon mosha 35-45 vjec.

Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat

Personeli akademik me kohë të plotë, të pjesëshme dhe stafi administrative dhe ndihmës punësohen sipas procedurave të diferencuara dhe për sejcilin lidhet kontratë punësimi. Për stafin PAE kontrata përmban të drejtat dhe detyrat e palëve, ku për stafin përcaktohen detyrimet e tij, në mësimdhënie, punë shkencore, shërbime për fakultetin, etj të gjitha këto të specifikuara dhe paga. Në disa raste komponenti i punës shkencore trajtohet me bonus shtesë duke mos u përfshire si pagesë bazë në kontratë. i punësuari njihet me elementët e kontratës.

Cilësia e stafit ndihmës/ administrativ për çdo njësi bazë

Nga vizita në institucion GVJ konstatoi se stafi ndihmës dhe administrativ u shërbente të gjithë programeve në UET. Angazhimi i tyre ishte serioz në mbarëvajtjen e procesit mesimor dhe shkencor në institucion. Rekrutimi i stafit ndihmës/administrativ për Departamentin, bazuar në dokumentacionin e paraqitur ishte sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, por edhe standardeve të punësimit në UET.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.1 - Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ angazhohen përmbrashen e objektivave të programeve të studimeve.	
Kriteri 1 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me objektivat e programeve të studimeve dhe përrritjen e tyre; Kriteri 2 Personeli akademik, ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ i institucionit angazhohen në përputhje me strategjinë përvillim të institucionit.	<p>Në realizimin e programit ka kordinim të personelit akademik, ndihmës dhe administrativ</p> <p>Stafi PAE dhe PAK angazhohet në procesin mësimor në lëndë sipas profilit të tij akademik dhe shkencor, syllabuseve të përgatitura dhe miratuar në department, dhe qartësimit të literaturës bazë, tekste bazë, tekste ndihmëse, literatura të vecanta sipas temave, etj. Programi ndiqet me rregjistrat e prezences dhe temave, kontrolleve periodike, asistimeve dhe diskutimeve në grup lendë. Performanca kontrollohet edhe nga Komisioni për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, i cili bën edhe rekomandimet e nevojshme përmirësimin e kërkuar, në përputhje me objektivat, strategjinë dhe aktet rregullatore në fuqi. KSBC harton cdo vit planin e veprimit te sigurimit të cilësisë i cili përfshin komponentin e mësimdhënieve, veprimtarisë shkencore dhe administrimin të cilësisë. Realizimi i strategjisë bëhet i mundur me angazhimin e personeli akademik dhe ndihmës Programet dhe syllabluset e reja janë iniciuar dhe formuluar e propozuar duke startuar nga njësia bazë deri në senatin akademik.</p>
Standardi II.4 - Personeli akademik angazhohet në hartimin dhe zbatimin e politikave të zhvillimit të institucionit.	


<p>Kriteri 1 Personeli akademik luan rol kryesor në hartimin e kurrikulës dhe në vendimet institucionale që i përkasin organizimit të programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Rekrutimi i personelit të ri dhe përcaktimi i ngarkesës mësimore bëhet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.</p>	<p>Gjatë vizitës në insitucion nga takimi me personelin akademik, konstatuam që ai është përfshirë intensivisht në përgatitjen e programit kryesisht nëpërmjet përgatitjes së syllabusve për cdo modul dhe në funksion të tyre edhe të kurrikulës së programit.</p> <p>Kurrikulat janë diskutuar në mbledhje të hapura departamenti, me antarë të Bordit të Tregut të Punës etj</p> <p>Rishikimi i fundit është bërë në 2016, që gjykojmë se ka qënë i justifikuar dhe argumentuar.</p> <p><i>Pajtohem i me sugjerimin e GVB që të kenë më shume peshë në vendosjen e curriculave grup lendët që janë afér në aspektin shkencor, shmanget dublimet apo përsëritjet dhe sjellin një ekspertizë të unifikuar shkencore.</i></p> <p>Nga takimi që zhvilluam me GVB ata na informuan që Departamenti i Financës dhe Ekonomiksit i cili mbulon programin diskuton dhe shqyrton në mbledhje të veçanta në menyre periodike programet e lëndeve me synimin edhe të shmangjes sa më shume të mbivendosjes mes lëndeve.</p> <p>Vendimet për hartimin dhe rishikimin e kurrikulave merren me propozim te departamenteve duke u miratuar në instancat më të larta të Këshillit të Fakultetit e më pas në Senatin Akademik. UET i ka të përcaktuara kriteret dhe procedurat për punësimin e personelit akademik efektiv dhe me kohë të pjesshme.</p> <p>Kriteret shpallen publikisht online dhe në gazeten Mapo, përzgjedhja e stafit bëhet me konkurs.</p> <p>Ngarkesa mësimore dhe shkencore janë caktuar paraprakisht ne kontratë. Mbi bazën e fushave akademike dhe orëve sipas planit mësimor është bërë ndarja e lëndëve duke respektuar edhe ngarkesat mësimore. Pedagogët e angazhuar në ciklin e dytë kanë ngarkesë mesim dhenien, praktikat mësimore, uheheqje diplomash, pa përmendur komponentët e punës shkencore apo edhe shërbimin në fakultet. Pedagogët kanë zhvilluar deri 4 lëndë në vit. Gjykojmë se ky kusht duhet rishikuar në emër të kualifikimit, specializimit dhe rritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies. Vihet re një ngarkesë e plotë me të gjithe komponentët e pedagogëve PAE që mbulojnë tashmë 97 % të ngarkesës në auditor</p>
--	--

Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin dhe vlerësimin e personelit.

<p>Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente për rekrutimin e personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruar të studimeve të ciklit të dytë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve respektive të</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion GVJ konstatot se procedurat për rekrutimin e stafit akademik mbështeten në kuadrin ligjor në fuqi lidhur me rekrutimin e personelit si dhe në aktet e brendshme rregullative të institucionit në këtë fushë.</p>
	<p>Nëse shohim evolucioni gjatë viteve të fundit lidhur me rolin në mësimdhënie të PAE dhe</p>

<p>studimeve;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për vende vakante, etj.</p>	<p>PAK, vemë re përballimin mbi 90% te ngarkeses akademike nga PAE konkretisht:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Për vitin 2015-2016 rezulton se 93% e programit është mbuluar nga PAE • Për vitin 2016-2017 rezulton se 93% e programit është mbuluar nga PAE • Për vitin 2017-2018 rezulton se 90% e programit është mbuluar nga PAE <p>Në rekrutimin e PAE dhe PAK, institucioni ka ndjekur procedura ligjore të saktësuara dhe transparente. UET publikon në web page dhe mjete tjera informimi si gazeta Mapo kërkosat, fusha që PAE ka, ku përcaktohet edhe dokumentacioni bazë, kërkosa e aplikantit, cv personale, kopje e diplomës universitare, pasuniversitare dhe e gradës apo titullit, lista e notave e vlerësimeve në të gjitha nivelet dhe rekomandimet. Përzgjedhja bëhet me konkurs.</p> <p>Eshtë hartuar plan asistimesh cdo vit akademik. Krahas kësaj janë organizuar forma të tjera si anketimet, feed back të studentëve të organizuara nga NJBVC. Rezultatet janë analizuar në mënyrë periodike në departament në fund të cdo viti akademik duke programuar edhe ndryshime e rekomandime të nevojshme</p> <p>Vleresimi i pedagogut kalon në tre shtylla tashmë të konsoliduara:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Nga përgjegjësi i departamentit; • Nga studentët, plotësimi on – line i pyetesorëve dhe vlerësimit me Fokus Grupe. • Nga drejtuesit e UET në fund të vitit akademik (procesi follow-up). <p>Zyra e Burimeve Njerëzore administron dhe Zyra e Arkivit ruan dosjet e aplikantëve, të komisioneve të intervistimit, vlerësimit të kandidatëve dhe njoftimeve për punë.</p>
--	---

Standardi III.2 - Personeli akademik (me grada shkencore dhe tituj akademikë) mbulon nevojat e institucionit dhe i ka të përcaktuara qartë përgjegjësitë.

<p>Kriteri 1 Përgjegjësi i programit ka të paktën titullin “Profesor i asocuar” ose, gradën shkencore “Doktor” (“PHD”) të fituar pranë universiteteve perëndimore dhe përvojë akademike në këto universitete;</p>	<p>Nga verifikimi i dokumentave që këruam gjatë vizitës ne institucion rezulton se të gjithë titullarët e lëndëve të angazhuar në zhvillimin e programit të studimit janë pedagogë me grada dhe tituj</p> <p>Përgjegjësi i programit, aktualisht përgjegjësi i departamentit ka titullin Prof. Asoc. Dr.</p>
<p>Kriteri 2 Titullari i lëndës/modulit në programet e studimeve “Master i Shkencave” ka të paktën gradën shkencore “Doktor”;</p>	<p>Titullarët e lëndëve të përfshirë në programin MSc. Financë – Bankë kanë të paktën gradën Doktor, dhe pothuaj të gjithë titullin akademik Profesor/Profesor i Asociuar. (Shih tabela 10 ne aneksin e këtij materiali dhe të dhënat shtesë lidhur me këtë problem gjatë vizitës në institucion)</p>
<p>Kriteri 3 Titullari dhe pedagogët e lëndës/modulit në programet e studimeve “Master profesional” ka të paktën gradën shkencore “Doktor” ose, diplomën “Master Professional” ose “Master Shkencash” dhe një përvojë profesionale së paku 5-vjeçare në profesionin në të cilin ofrohet ky program studimi;</p>	<p>Titullarët e lëndëve kanë eksperiencë pune mbi</p>
<p>Kriteri 4 Rektori, zv/rektori, drejtori dhe zv/drejtori</p>	

i qendrës ndëruniversitare, dekani, zv/dekani, drejtori, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në institucionin që ofron programin e studimeve;

Kriteri 5 Institucioni siguron personel të mjaftueshëm për udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e praktikave profesionale.

pesë vjet në fushën e studimit sipas programit. Rektori, zv/rektori, drejtori dhe zv/drejtori i qendrës ndëruniversitare, dekani, zv/dekani, drejtori, përgjegjësi i departamentit, përgjegjësi i shërbimit, përgjegjësi i programit janë të punësuar me kohë të plotë në UET

Zyra e karierës ka vendosur bashkëpunim dhe kontakte me institucione financiare, bankare, të sigurimeve dhe biznese të tjera, duke alokuar në to studentët për praktikën profesionale. Sidoqoftë numri i studentëve që duhet të ndjekin për praktika dhe në të njëjtën kohë edhe monitorimi për diplomatështë I lartë.

Standardi III.5 - Studentët që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë "Master i Shkencave" apo programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë kanë udhëheqës për tezën.

Kriteri 1 Studentët që ndjekin këto programe studimesh kanë një udhëheqës për punën kërkimore dhe tezën që përgatisin përmarrjen e diplomës në përfundim të studimeve të këtij cikli;

Kriteri 2 Udhëheqësi ka të paktën gradën shkencore "Doktor";

Kriteri 3 Udhëheqësi nuk mbikëqyr më shumë se 5 (pesë) studentë njëkohësisht për temat me karakter kërkimor të aplikuar (si ato të ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave të natyrës, shkencave mjekësore, etj.) dhe më shumë se 10 (dhjetë) studentë njëkohësisht për temat e ofruara në programet e studimeve në fushat e shkencave shoqërore e humane.

Sipas planifikimit nga njësia bazë dhe pjesë e detyrimit kontraktor në mësimdhënie dhe punë shkencore me studentët eshtë edhe tema e diplomës. Departamenti ka përgatitur një listë fushash interesante dëshmonës përfundim të studimeve të ciklit të dytë. Zyrtarisht, studentët kanë bashkëpunim me pedagogët udhëheqës punojnë në këtë drejtim. Zhvillohen edhe sëancë metodologjike përgatitjen e diplomave, si në fushën e shkrimit akademik, takime të personalizuar në lidhje me temën me synim cilësinë e punimit të temave të studentëve.

Udhëheqësit e diplomave janë me grade doktor e sipër.

Në departamentin e Financës dhe Ekonomiksit të gjithë udhëheqësit e kanë gradën shkencore doktor e lart.

Mbi 75 % e udhëheqësve kanë titullin profesor i asocuar dhe profesor.

Nga vizita në institucion, dhe sic theksohet edhe në RVB, kriteri përmes mos drejtuar mbi 5 studentë nuk është zbatuar nga Departamenti i Financës & Ekonomiks. nga 11 pedagogë që jepin mësim në të dy programet e studimit MSH dhe MP, të 11 janë me mbi 15 udhëheqje ,5 pedagogë të tjera janë me mbi 20 udhëheqje.

Kjo ka cënuar cilësinë e diplomave, përmes punimit të krediteve gjithsej të programit. Lind nevoja e rishikimit dhe shpërndarjes së diplomave edhe përgjegjës përmes pedagogëve të jashtëm të departamentit aktivizuar vitin e fundit ose vitet paraardhëse akademike e që bashkëpunojnë me UET.

Ndërkohë mundësitetë dëshmonës përfundim të studimeve të ciklit të dytë kanë udhëheqës përmes mos kontrollin e plagjiaturave përmes punimit të krediteve gjithsej të programit. Lind nevoja e rishikimit dhe shpërndarjes së diplomave edhe përgjegjës përmes pedagogëve të jashtëm të departamentit aktivizuar vitin e fundit ose vitet paraardhëse akademike e që bashkëpunojnë me UET.

Standardi III.6 - Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi eshtë në

përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit dhe është parashikuar të përgatitet teza.



<p>Kriteri 1 Fusha studimore-kërkimore në të cilën është specializuar udhëheqësi është në përputhje me fushën studimore në të cilën ofrohet programi i studimit.</p> <p>Kriteri 2 Udhëheqësi ka njohuri të avancuara teorike dhe aftësi të veçanta kërkimore në fushën në të cilën ofrohet programi i studimeve dhe në të cilën është parashikuar të hartohet teza.</p>	<p>Udhëheqësit shkencor për kandidatët caktohen bazuar në kërkesën e studentëve dhe propozimin e tyre të fushës së punimit të mikrotezës në Departament. Miratimi i listës së udheheqësve shkencor për cdo student shpalen publikisht.</p> <p>Departamenti në miratimin e tezës master synon që udhëheqësi të ketë ekspertizën e nevojshme sipas programit të studimit dhe temës së propozuar. Që të respektohet ky kriter realisht pavarësisht përpjekjeve të Departamentit lipset plotësimi i standartit III-5 kriteri 3 i sipërcituar.</p> <p>Udhëheqësit kanë njohuritë e duhura dhe aftësi kërkimore, por ka raste që nevojitet më shumë eksperiencia e tyre e drejtëpërdrejtë profesionale</p> <p><i>Sidoqoftë numri i lartë i diplomave për pedagog, 10-20 e vështirëson respektimin e këtij kriteri. Në rastet kur nuk sigurohet kjo përputhje, departamenti duhet të caktojë në pedagog të jashtëm brenda kritereve të kërkuara.</i></p>
---	---

Standardi III.7 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor-shkencor dhe administrativ për përbushjen e misionit të tij.

<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbatjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon një përdorim optimal të burimeve njerëzore për përbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të dyt.</p>	<p>Stafi i Zyrës së IT-së, angazhohet për mirëmbajtjen e laboratorëve të informatikës, dhe pajisjeve ndihmëse në auditore, është i kualifikuar dhe në dispozicion të studentëve dhe pedagogëve përgjatë gjithë kohëzgjatjes së zhvillimit të mësimit.</p> <p>Angazhimi në procesin mësimor, shkencor bëhet mbi kritere të matshme nga ana sasiore, ngarkesat, sistemin e pikëve, etj. Pra përdorimi i tyre dhe mbingarkesa kanë qënë dukuri për PAE dhe PAK. Ka standarte për ndarjen e ngarkesës mësimore, balancimin mes mësimdhënies dhe detyrave të tjera të personelit akademik. Puna administrative dhe shërbimi është detyrim kontraktor pjesërisht për stafin PAE.</p> <p>Përsa i përket personelit administrativ, ai është organizuar kryesisht në shkallë fakulteti dhe universiteti, për nga numri, ai zë peshë të ndjeshme në punësimet në UET, është në shërbim të studentëve dhe personelit akademik përmbarëvajtjen e procesit akademik.</p> <p>Për të siguruar zhvilimin e rregullt dhe cilësor të praktikave profesionale në UET funksionon Zyra e Karrierës dhe Praktikave, e cila ka lidhur memorandume bashkëpunimi me shumë insitucione publike dhe kompani private</p>
--	--



Standardi III.8 - Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

<p>Kriteri 1 Personeli akademik realizon ngarkesën mësimore të përcaktuar në aktet ligjore e nënligjore në fuqi;</p>	<p>Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit Msc në Financë Bankë me profile, e</p>
---	--



<p>Kriteri 2 Ngarkesa mësimore e zhvilluar nga personeli akademik në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë dhe organizimi e drejtimi i tyre, vlerësohen me orë mësimore.</p>	<p>realizon ngarkesën mësimore sipas parashikimeve të kontratës së punës dhe akteve rregullatore të institucionit.</p> <p><i>Sugjerojmë që në normimin e ngarkesave të shihen metodologja që zbatohet për Universitetet Publike përsa i përket elementëve të ngarkesës. Temat e diplomës konsiderohen pjesë e procesit mësimor dhe si të tilla nuk përfshihen në ngarkesën e normuar në orë fizike.</i></p> <p>Ngarkesa mësimore vlerësohet me orë mësimore, në nivelin master përdoret koeficent konvertimi, 1.25 me orën fizike. Të gjithë elementët e ngarkesës sic u përshkrua në rubrikën e rekrutimit janë pjesë e kontratës dhe vlerësohen nga ana sasiore e cilësore e të lidhura edhe me shpërblimin. Për ngarkesën e stafit në të gjitha programet e studimit për vitin akademik 2017-2018, në dokumentacionin e sjellë nga institucioni rezulton:</p> <p><i>Stafi PAE:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> 4 pedagogë mbulojnë 4 lëndë; 8 pedagogë mbulojnë 3 lëndë; 1 pedagog mbulon 2 lëndë; <p>Ngarkesa orë në auditor paraqitet: nga 150 deri në 304.5 orë.</p> <p><i>Stafi PAK:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> 2 pedagogë mbulojnë nga 1 lëndë. <p>Ngarkesa orë në auditor paraqitet: nga 70 deri në 71.5.</p>
--	---

Standardi III.9 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.

<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon për secilin semestër listën e plotë të personelit akademik, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe personelit administrativ;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni përcakton dhe publikon kriteret dhe procedurat për rekrutimin e personelit akademik.</p>	<p>Për cdo anëtar stafi dhe të përfshirë në program, Departamenti ka të dhëna për formën e punësimit, ngarkesën e secilit anëtar të personelit akademik, fushën ku angazhohet, etj. Në formë më të plotë për të gjitha vitet e karierës dhe ato në UET, për performancën e stafit, Zyra e Burimeve Njerëzore ka të dhëna mbi sejcilin anëtar, si CV personale, angazhimin, performancën, kontratën etj. Ajo i përpunon këto të dhëna në nivel institucional.</p> <p>Zyra e Burimeve Njerëzore, dhe departamenti kanë të dhënat për stafin, i rifreskojnë ato me informacionin e fund vitit akademik, mbi angazhimet e reja dhe largimet cka dëshmohet edhe në tabelat 2,3, 4 mbi stafin PAE dhe PAK, në anekset e këtij materiali.</p> <p>Cdo vit nga zyra e Burimeve Njerëzore, Rektorit, publikohen vendet vakante sipas kërkesave të departamenteve dhe me autorizim zyrtar me kohë të plotë dhe të pjesëshme.</p> <p>Në shpalljen e publikuar për rekrutim personeli liston të gjitha kriteret e nevojshme dhe dokumentacionin për të aplikuar</p>  
--	---

Konkluzionet e vlerësimit:

Gjykojmë se personeli akademik i angazhuar për drejtimin dhe zhvillimin e programit të studimit respekton kriteret e përcaktuara, me grada dhe tituj, eksperiencë në mësimdhënie. Ai angazhohet në mësimdhënie dhe shërbime ndaj institucionit. Në funksion të kërkesave të tregut, rishikimi i programeve dhe syllabluseve, rritja e fleksibilitetit të profileve etj, duhet të përfshijë më shumë ekspertizë e konsultim me programet bashkëkohore, më shumë propozim në nivele grup lëndësh.

Rol të rëndësishëm në mbështetjen e mirëorganizimit të procesit mësimor ka edhe personeli administrativ. Personeli është i mirëinformuar për rregullat e institucionit dhe objektivat e misionin e tij. I gjithë dokumentacioni rregullues i UET-it, dhe aktet kryesore ligjore që rregullojnë veprimtarinë e institucionit janë të publikuara në një folder të përbashkët, në intranet. UET ka të dhëna të detajuara sa i takon personelit akademik të angazhuar, formës së punësimit dhe ngarkesës së realizuar.

Kerkohet riorganizim i punës për udhëheqjen e diplomave, rishikim i ngarkesës së diplomave për cdo pedagog, krijimi e funksionimi sistemit të plagjaturës në diploma, shpërmdarja e tyre në ekspertë apo personalitetë të fushës respektive brënda apo jashtë fakultetit të universitetit, pra kerkohet një rikonceptim i këtij elementi ngarkese.

Krahas kësaj ritheksojmë se ky element përbërës në programin e studimit, mund të vlerësohet me më pak kredite duke krijuar hapsirë për lendë apo module të reja që përafrojnë programin më mire me tregun e punës dhe rrisin fleksibilitetin e profileve.

Standartet e mësipërme plotësohen kryesisht

Rekomandime:

'- Duhet rikonceptuar e gjithë puna për diplomat që nga numuri i kreditave, problematika, numri i udhëheqjeve, problemi i plagiaturës, etj. Pavarësisht hapave të bëra, gjykojmë se ky problem duhet rishikuar për të rritur cilësisht këtë konponent të formimit.

4. Infrastruktura në funksion të programit të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: mjediset, infrastruktura, teknologjite e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët, residencat.

Mbështetur në informacionin në RVB, Universiteti European i Tiranës ndodhet në Bulevardi "Gjergj Fishta", Nd. 70, H1, Tiranë. Godina ka sipërfaqe rreth 10.000 m² dhe parking për 120 automjete.


Objekti ka dy shkallë, njëra shkallë emergence, I pajisur me mjete kundër zjarrit, fikse zjarri në çdo kat, gjithsej 30 copë, sistemin e mbrojtjes kundër shkarkesave atmosferike.

Ka furnizim alternative me energji elektrike, ka të garantuar rezerva të mjaftueshme të ujit të përdorshëm, nga rrjeti publik i ujit të pijshëm dhe pus uji reserve. Ka system ngrohjeje që funksionon normalisht.

UET ka në dispozicion tre godina:

- 1- Godina A e përbërë nga 4 kate, ku çdo kat ka një sipërfaqe prej 1000m².
- 2- Godina B e përbërë nga 4 kate, ku çdo kat ka një sipërfaqe prej 1000m².
- 3- Godina C (biblioteka) gjithsej 300 m².

UET ka aktualisht në përdorim 4 laboratorë mësimorë informatike, përkatësisht Lab 205 B me 25 PC dhe video projektor; Lab 206 B me 35 PC dhe video projektor; Lab 207 B me 35 PC dhe video projektor; Lab 208 B me 80 pc (laboratori i internetit) dhe 33 salla mësimore, (leksione dhe seminare) të gjitha të pajisura me mjete audio vizive si PC, projektorë dhe foni në rastin e sallave të



leksionit. Biblioteka njëkohësisht ishte e paisur me 14 pc në mënyrë që studentët të kishin mundësi të lexonin on-line.

Laboratorët e informatikës/statistikës janë pajisur me softwaret përkatës që t'i shërbejnë sa më mirë programit mësimor. Për informatikën e avancuar, statistikën dhe programin master në informatikë ekonomike janë instaluar programet si Navicat for my SQL; NetBeans; Apache Tom Cat; SPSS 19. Të gjithë laboratoret janë të pajisur me mjetet didaktike të nevojshme për zhvillimin modern të procesit mësimor. Pajisjet mirembahan nga stafi zyrës teknologjisë së informacionit, dhe azhornohen kohë pas kohe programet. Janë instaluar programet aplikative sipas kërkesave të departamenteve përkatëse. Me sistemin moodle(UET lms), studenti në kohë reale azhornohet me materialet e pedagogut leksione, materiale shtesë audio vizive etj dhe mund edhe të komunikojë me pedagogun, kolegët, të njihet me pikët dhe notat e tij,etj.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Mjediset për Programin e studimit

Bazuar në dokumentacionin e institucionit, raportin e vlerësimit të brendshem, si dhe nga verifikimi që u bë gjatë vizitës në institucion rezultoi se UET ka në dispozicion për të gjithë programet e studimit tre godina:

- Godina A është e përbërë nga 4 kate, ku çdo kat ka një sipërfaqe prej 1000m^2 .
- Godina B është e përbërë nga 4 kate, ku çdo kat ka një sipërfaqe prej 1000m^2 .
- Godina C (biblioteka) gjithsej 300m^2 . Këto sipërfaqe janë të ndara në salla leksionesh, gjithsej 10 salla me sipërfaqe totale 1510m^2 dhe 1515 vende.
- Salla seminari janë gjithsej 14, me sipërfaqe 45m^2 dhe secila me nga 35 karrige.
- Salla 70 vendeshe (leksione + seminare) janë gjithsej 9 salla me sipërfaqe 100m^2 secila.
- Salla për departamentet janë gjithsej 8 ambiente me sipërfaqe 45m^2 secila.
- Salla për laborator informatike janë 3 salla me sipërfaqe 45m^2 secila me kapacitet 35 vende.
- Sallë interneti me sipërfaqe 165m^2 me 80 kompjutera.
- Salla për bibliotekën ka sipërfaqe 300m^2 , 150 vende leximi.
- Mjedisi për fotokopje dhe librari ka sipërfaqe 150m^2 .
- Mjedisi çlodhes për kafe/fast-food/etc është në një sipërfaqe të vetme.
- Nyje hidrosanitare janë gjithsej 48 me sipërfaqe 300m^2 .
- Mjedise për aktivitetet e qeverisë studentore janë 3 me sipërfaqe 140m^2 .
- Zyra për dekanin/zv.dekanin/kancelarin janë 5 me nga 20m^2 .
- Zyra për përgjegjës departamenti janë gjithsej 8 ambiente me nga 18m^2 .
- Zyra për kordinatore janë gjithsej 6 ambiente me nga 14m^2 .

- Zyra për pedagogët janë 30 me sipërfaqe $14m^2$ secila dhe një sallë e madhe me sipërfaqe $150m^2$, me 32 poste pune.
- Zyra për sekretarinë mesimore janë 3 me sipërfaqe $140m^2$.
- Zyra për stafin akademik dhe administrativ janë 12 me sipërfaqe $350m^2$
- Zyra informacioni për studentët janë 2.
- Korridore plus holle janë gjithsej 8 me $150m^2$ secili. $500m^2$

Biblioteka

Biblioteka është synuar të pasurohet cdo vit me tekstet të reja bazë dhe literaturë të rekomanduar; me blerje, përkthime dhe botime nga UET të teksteve universitare dhe monografive shkencore me pedagogë të UET autorë vendas e të huaj. Eshtë bërë kujdes përfondin e revistave shkencore, si Polis, Economicus, Jus dhe Justicia dhe Sociological Analysis dhe Educatio që botohen nga UET. Eshte aplikuar edhe blerja online në Amazon.com.


Kërkesat për tituj janë adresuar nga departamentet dhe dekanatet e miratuar nga organet drejtuese të UET.

Ka abonime në revista shkencore në hard copy, ku ofrohen mijra tituj librash dhe artikujsh shkencorë si: Sage, Ebsco (abonim 5-vjeçar), Questia; në revista shkencore si Harvard Business Review; The Economist; Foreign Affairs; Commentaire; The Nations Interest; The American Interest; Educational Leadership etj dhuruar nga shoqata, ambasada dhe individë e fondacione të ndryshme.

Nga vizita në institucion na ra në sy mungesa e teksteve të autorëve shqiptarë në fusha të ndryshme të kurikulave, qe janë tashmë në qarkullim gjë që do ta sugeronim se pavarësisht nëse rekomandoohen ose jo në auditorë, duhet të jenë pjesë e fondit të bibliotekës.


Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.5 - Institucioni siguron infrastrukturën e nevojshme për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe të programeve të integruarë të studimeve të ciklit të dytë që ofron.	
Kriteri 1 Institucioni ka një vendndodhje të përherershme, që nënkupton mjedis qendror administrativ dhe mjedis ku zhvillohet veprimtaria mësimore;	UET vazhdon te kete te njëjtën vendndodhje që nga krijimi i tij ne shtator 2007, në Blv. Gjergj Fishta, Nd. 70, H.1, është në proces ndërtimi kampusi i ri modern në Sauk, UET përdor tre godina, përkatësisht Godinat A dhe B ku zhvillohet procesi mësimor dhe Godinën C ku ndodhet Biblioteka. Ka infrastructure të mjaftueshme nga ana sasiore e cilësore, në raport me numrin e studentëve apo përdoruesve të tjera të kësaj infrastrukturre.
Kriteri 2 Këto mjedise janë në dispozicion të institucionit për jo më pak se 6 vjet;	Infrastruktura e tij është përmirësuar vazhdimesht duke ofruar hapësira të nevojshme dhe komode
Kriteri 3 Nëse programi i studimit ofrohet në më shumë se një godinë, institucioni siguron menaxhim efikas dhe kontroll të vazhdueshëm përritjen e standardeve dhe zbatimin e politikave arsimore të hartuara për realizmin e programeve të studimeve që ofron;	Godinat janë afér, mund të aksesohen lehtësisht Mësimi në ciklin e dytë zhvillohet kryesisht nga e mërkura në të premete, 17:00-20:00 dhe të shtunave 9:00 – 16:00.
Kriteri 4 Institucioni garanton kapacitete dhe mjedise të mjaftueshme për realizimin e praktikave profesionale të parashikuara për realizimin e programeve të studimeve në fushat e shëndetësisë, veterinarisë, bujqësisë, shkencave teknike, etj.	Për programin në shqyrtim, infrastruktura në shkallë universiteti, si laboratoret, sallat, bibliotekat, etj janë lehtësisht të aksesueshëm.
Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.	



<p>Kriteri 1 Institucioni siguron tekste mësimore cilësore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme dhe bashkëkohore;</p>	<p>Për realizimin e këtij programi institucioni vë në dispozicion të studentëve tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse Në përgjithësi tekstet bazë janë në gjuhë të huaj (kryesisht anglisht). Për disa nga lëndët ka tekse ndërkombëtar universitar të përkthyer nga autorë të njohur sidomos në fushën e bankave tregjeve financiare etj. Për disa lëndë ka dhe literaturë mbështetëse.</p>
<p>Kriteri 2 Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p>	<p>Përdorimi i tyre, rrjedhojë e diferençave në ambientin ekonomik te vendit tonë me vendet e origjinës së librave të botuara, ka vështirësi. Edhe niveli i njohjes së gjuhës e rrit vështirësinë të teksteve e materialeve në anglisht. Përdorimi i literaturës në shqip nga autorë vendas është i mangët.</p>
<p>Kriteri 3 Në bibliotekë ka botime periodike dhe librari elektronike, të cilat përbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës;</p>	<p><i>Bazuar ne vizitën që ne bëmë në bibliotekë thuaj se mungojnë botime të autorëve vendas në disciplina bazë apo edhe në ato me zgjedhje</i></p>
<p>Kriteri 4 Përgjegjësit e programit kanë hartuar një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit të studimit, të projektit kërkimor shkencor dhe për përgatitjen e tezës nga studentët, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për këtë qëllim;</p>	<p>Inventari i bibliotekës në fushën e shkencave ekonomike me 1178 tituj, nga të cilët 845 në shqip dhe 333 tituj gjuhë të huaj (anglisht, frëngjisht, italisht, gjermanisht) tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse ofron literature të mjaftueshme bazë për programin msc Financë-Bankë.</p>
<p>Kriteri 5 Biblioteka ka orare të shërbimit në përshtatje me oraret e programeve të studimeve dhe nevojat e studentëve.</p>	<p>Biblioteka e UET ka literature thuajse në gjuhë të huaj për cdo lëndë, hard copy apo online, disa përkthime bazë, që ndihmon në përvetësimin e dijeve sipas programit dhe lëndëve mësimore. Biblioteka k a6144 tituj për studentët, 170 vende leximi dhe 10 kompjutera.</p>
	<p>Sipas RVB dhe vizitës në institucion, Biblioteka furnizohet me botime periodike, me burimeve on-line të kërkua nga pedagogët dhe studentët. Referuar RVB Biblioteka e UET, ka siguruar akses në burime ndërkombëtare elektronike për artikuj dhe libra shkencore si: EBCSO, Questia, Social Science Library, Elsevier. Biblioteka është pjesë e sistemit COBISS (Sistemi dhe shërbimet e përbashkëta bibliografike online). COBISS.Net është një rrjet ku janë të përfshira të gjitha vendet e rajonit të Europës Juglindore, e cila përfaqëson një model organizativ të lidhjes së ibliotekave në sistemin kombëtar të informacionit bibliotekar me katalogim të përbashkët, me bazën bibliografike (katalogun) të përbashkët të dhënavë dhe me bazat lokale të bibliotekave pjesëmarrëse.</p>
	<p>Përgjegjësit e programit listojnë kërkesat për shtimin e botimeve për bibliotekë sipas nevojave të programeve që mbulojnë. Rruge e përdorur me eficiencë është ajo elektronike.,</p>
	<p>Biblioteka e UET sherben me orare të aksesueshme për të gjitha programet e studimit, 9,00-20,00</p>

Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë të mjaftueshmë dhe mjedise të përshtatshme mësimore.



Kriteri 1 Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimeve;

Kriteri 2 Pajisjet e mjediseve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;

Kriteri 3 Laboratorët përbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve dhe për zhvillimin e praktikave të parashikuara nga programi i studimit, në përputhje me qëllimet e programit, si dhe mirëmbahen dhe janë në përmirësim të vazhdueshëm;

Kriteri 4 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator, për secilin grup leksionesh ku parashikohen praktika laboratorike.

Pajisjet dhe infrastruktura në këtë institucion janë të mjaftueshme dhe të pajisura si duhet sipas qëllimeve dhe objektivave të programit. Klasat mësimore janë pajisur me pajisjet audio vizive si PC, projektorët, sistemi i foniës.

E njejtë gjë duhet thënë për laboratorët me kompjutera, programe sipas kërkesave të programit, lëndëve bazë dhe të vecanta. Salla e laboratorit përdoret kryesisht në lëndët e statistikës.

UET ka ndërtuar Sistemin e Menaxhimit të Mësimdhënieve UET LMS. Ky sistem një risi bashkëkohore që përdorin universitetet e njohura në botë në informatizimin dhe menaxhimin e mësimdhënieve online. Studentët kanë akses në lëndët e tyre përkatëse dhe në literaturën e lëndëve që mbulojnë.

Sistemi mundëson për pedagogët dhe studentët akses të plotë mbi lëndët, programet, materialet mësimore, etj.

Konkluzionet e vlerësimit:

GVJ vlerëson se struktura e programit, e integruar në atë të institucionit është e mjaftueshme dhe e përshtatshme, në aspektin sasior e cilësor për realizimin cilësor të programit, Kjo, përsa i përket ambjenteve mësimore, sallave të laboratorve, të bibliotekave, të ambjenteve të tjera ndihmëse e të shërbimit, etj. Janë të gjitha mjetet didaktike të nevojshme për studentët dhe pedagogët, Ka sistem interneti, wireless, sallat e leksionit janë organizuar në formë amfiteatri me sistem fonie dhe me PC dhe projektor. Laboratorët e informatikës disponojnë programet e nevojshme sipas programit mësimor. Personeli akademik i brendshëm me grada është i akomoduar në zyra dyshe.

Drejtuesit e njësive bazë, dekanët, zv. rektorët dhe drejtuesit e tjere kanë zyra të vecanta. Biblioteka funksionon me orar të gjatë dhe ofron kushte të mira. Rekomandojmë pasurimin e saj me tekste bazë dhe ndihmëse në përputhje me kurikula të autorëve vendas. Edhe niveli i zotërimit të gjuhës së huaj, megjithë përmirësimet në pranime e kushtëzon këtë problem, Biblioteka duhet pasuruar edhe me botime hard copy në gjuhë të huaja. Në UET funksionon sistemi i menaxhimit të mësimdhënieve online (UET LMS) standart ky që mundëson informacionin, midis studentëve, pedagogëve dhe kontribuon në menaxhim të mire të mësimdhënieve.

GVJ vlerëson se infrastruktura që është në dispozicion të zhvillimit të procesit **mësimor plotëson plotësisht standardet dhe kriteret e cilësisë**.

5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare kushtëzon mbarëvajtjen e procesit.

Si burime financiare UET përdor tarifat; aktivitetet tregtare, grantet për kërkime dhe kontratat. (Shih tabela 8). Këto të fundit pas vitit 2013. Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në tre vitet e fundit kanë ardhur nga tarifat për dhe gjatë shkollimit, aktivitetet tregtare (qeradhenie, parkim etj.) grantet për kërkim edhe kontratat.

Një zhvillim pozitiv ne kete drejtim gjate 3-4 vitet e fundit janë burime financiare te siguruara nepermjet kontributeve dhe granteve për kërkim dhe kontratat ne kuader te projekteve ku institucioni eshte pjesemarres dhe perfittues. Universiteti European i Tiranës kryen kontroll dhe audit çdo vit.

Ndonse ka një rerie të lehtë ndaj vitit 2015-2016, në vitin 2016-2017 ka një rritje të të ardhurave nga tarifat e shkollimit në masën 8.3 %.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:



Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në këtë program studimi (në përqindje sipas Tabelës 8 në RVB):

Të ardhurat nga:	Viti (2014)	Viti (2015)	Viti (2016)
Grandet për kërkim dhe kontratat	3.033.080	7.607.575	19.984.477
Tarifat për dhe gjatë shkollimit	645.120.809	679.213.964	735.953.246
Aktivitetet tregtare (qeradhenie, parkim etj.)	39.006.924	127.723.768	104.950.864
SHUMA	687.160.813	814.545.307	860.888.586

Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik (në përqindje sipas RVB)

Shpenzimet për studentët që ndjekin programet e studimit për tre vitet e fundit akademike janë:

Viti akademik	Nr. studentëve	Kosto për student (lekë)
2014-2015	3.428	175.980
2015-2016	4.149	165.100
2016-2017	4.066	182.500

Kontrolli i brendshëm finanziar, auditimi dhe rezultatet.

Universiteti European i Tiranës auditohet cdo vit, harton raport transparence financiare, me opinion të audituesit të pavarur për pozicionin financiar, performancen dhe perputhjen me standartet e kerkuara te kontabilitetit.

Pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë në të gjitha drejtimet aspektet materiale, si dhe rezultatin e operacioneve të saj dhe rrjedhjes së parasë për vitin e mbyllur .

Kapacitetet menaxhuese financiare

Projekti finansiar hartohej në muajin korrik të çdo viti dhe miratohet nga aksioneri i vetëm Z. Henri Çili. Për zbatimin e tij janë struktura e Administratorit, Zyra e Financës.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi II.9 - Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm dhe/ose të brendshëm) të situatës financiare.	
Kriteri 1 Raporti i auditit paraqet të gjithë situatën financiare për përdorimin e buxhetit të vënë në dispozicion për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruarë të studimeve të ciklit të dytë;	UET përgatit reportin vjetor cdo vit. Reportet janë transparente përmbytëse elementët e nevojshëm për vlerësimin e situatës financiare, të ardhurat, shpenzimet, burimet e financimit, të ardhurat për cdo student, për kontabilizimin, shfrytëzimin dhe eficencen e të ardhurave për funksionimin e institucionit. Për secilin vit akademik institucioni harton reportin për koston për secilin program. Raporti auditit trajton shkurt reportin midis të ardhurave dhe shpenzimeve, drejtimet e
Kriteri 2 Raporti i auditit përbën një pasqyrë të quartë të granteve të huaja të përfituarë dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruarë të studimeve të ciklit të dytë;	
Kriteri 3 Raporti i auditit analizon eficiencën e përdorimit	

<p>të tē ardhurave nga tarifat e studentëve në funksion të rritjes së cilësisë së studimeve në këtë cikël studimesh.</p> <p>Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport finançiar të kostove të programeve të studimeve.</p> <p>Kriteri 1 Institucioni harton një raport që pasqyron të dhëna të hollësishme finançiare të kostove për realizimin e programeve të studimeve, si kostot operacionale, kostot fiksë të mjediseve dhe të pajisjeve, etj.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon se ka një qëndrueshmëri finançiare përgjatë kohës së zhvillimit të programeve të studimeve dhe se ka kapacitete finançiare të mjaftueshmë për përmirësimin e situatës finançiare dhe gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen.</p>	<p>përdorimit të tē ardhurave dhe pasqyron tendencën e tyre ndër vite.</p> <p>Institucioni bën auditim të përvitshëm të situatës finançiare të tij. Analizon kostot e cdo programi, për shpenzime të matëshme, koston fiksë të përbashkët, të pajisjeve dhe ndjek planin e investimeve. Duke vepruar kështu, kontrollon lehtë ecurinë dhe vazhdimësinë konform rregullave dhe standardeve. Bazuar në numrin e studentëve të regjistruar gjatë gjithë viteve pas akreditimit të parë në programin Msc në Financë Bankë me profile, në nivelin e tarifës që paguajnë gjykojmë se kjo siguron qëndrueshmërinë finançiare të programit të studimit. Burinet e sigurara, i japin mundësi institucionit që tē rrisë investimet e rritjen e shërbimeve për studentët dhe infrastrukturës së institucionit. Institucioni paraqet stabilitet tē ardhurave dhe finançimeve, trend në rritje të tyre nga viti në vit, cka e bën stabile situatën finançiare të tij.</p>
<p>Konkluzionet e vlerësimit:</p> <p>Financimi dhe menaxhimi i burimeve finançiare bëhet konformë rregullave dhe ligjeve në fuqi, ka transparence, mbështetet në buxhete të planikuara e miratuara, në struktura që ndjekin të ardhurat dhe shpenzimet gjithsej dhe sipas programeve, dhe hartojnë dhe certifikojnë cdo vit pasqyrat finançiare me auditë të jashtëm. Situata finançiare paraqitet stabile gjë që garanton ecurine dhe financimin e mëtejshëm të programeve të studimit.</p> <p>Standarti plotësohet plotësisht</p>	

6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

Pjesa përshkrimore

Terma reference: institucionalizimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, ngritja e Njësisë së SBC, funksionimi i saj, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme

Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (KSBC), e ka nisur punën që me krijimin e institucionit, në formën e grupeve ad hoc, dhe nga Janari 2011 si njësi e përhershme në strukturën organizative të institucionit.

Me rregull tē brendshëm tē institucionit komisioni është ripërtrirë çdo dy vjet, gjë që gjykojmë se krijon problem në drejtim të kualifikimit, specializimit, trainimit dhe të kuptuarit e detyrave dhe rolit të KBVC.

Komisioni ka vlerësuar periodikisht efikasitetin e veprimtarive mësimore e kërkimore, administrative e finançare të UET-it. Ai ka akses në të gjitha të dhënat e institucionit. Në procesin e verifikimit të brëndshëm të cilësisë UET ka përfshirë edhe ekspertë të jashtëm për më shumë objektivitet dhe paanshmëri në gjykim. Janë ngritur Bordet e Besimit dhe Bordet e Tregut të Punës për t'u konsultuar me aktorë të jashtëm. UET ka përfshirë si partnerë në dy projekte europiane me fokus sigurimin e cilësisë së brendshme nga institucionet e arsimit të lartë, projektin TEMPUS

“ENCHASE” dhe Erasmus+: QAinAL. Në funksion të cilësisë është synuar edhe aktiviteti “International Quality Assurance Programme” organizuar nga Agjencia Britanike QAA.

Ndërkojë, në mënyrë periodike KSBC informon drejtuesit e fakulteteve, e përmes tyre të gjithë stafin e UET-it rrreth rezultateve të kontolleve të zhvilluara, me synim marrjen e masave për përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së institucionit, njësive të tij bazë dhe individëve në të ardhmen.

Veprimitaria e kësaj zyre bazohet ne planin kalendarik te veprimitarise së përvitshëm, në të cilin programohen kontrolllet në sektorët apo proceset që i nënshtronen kontrollit e që shoqërohen me raportet me gjeljet përkatëse. Ndërkojë, në mënyrë periodike KSBC informon drejtuesit e fakulteteve, e përmes tyre të gjithë stafin e UET-it rrreth rezultateve të kontolleve të zhvilluara, me synim marrjen e masave për përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së institucionit, njësive të tij bazë dhe individëve në të ardhmen.

Formë e verifikimit të cilësisë është pyetësori me studentët, i organizuar dy herë në vit, në përfundim të çdo semestri, për të gjitha programet e studimit, për të gjitha ciklet, për të gjitha lëndët dhe pedagogët. Ndonëse numri, kampioni dhe përqindja e studentëve të anketuar nuk është gjithëpërfshirëse, ajo ka kontribuar në leximin e feed back të studentëve. Nga përpunimi i pyetorëve kanë dale opinione e problem, rekomandime mbi cilësinë e punës së secilit, duke marrë edhe masat konkrete ndaj pedagogëve të ndryshëm.

Kontrolli i provimeve është formë tjetër kontrolli. Katër herë në vit KSBC kryen këtë proces, rezultatet e të cilil pasqyrohen në raportet përkatëse. Eshtë përdorur edhe forma e takimeve të drejtuesve të institucionit me studentët, tërheqja e mendimit nga “fokus grupet” si edhe pyetësorët me frekuencë simestrale apo mbi një problem specifik,. Të dhënat nga këta pyetësorë, shfrytëzohen në mbështetje të procesit të followup-it, me të cilin drejtuesit e institucionit vlerësojnë performancën akademike të cdo pedagogu në përfundim të vitit akademik.

Duke filluar nga viti akademik 2016-2017 UET ka vënë në përdorim platformën LMS (Learning Management System) për menaxhimin e mësimdhënieve online. Ky system sherben për KSBC-së për monitorimin e procesit dhe evidentimin e problematikave të ndryshme në mësimdhënie.

Kjo njësi përbëhet nga 11 antarë (**Tabela 6 tek Anekset**)

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC për programin e studimit, si:

Gjatë vitit akademik realizohen 2 anketime me studentët dhe konkretisht në përfundim të procesit mësimor te cdo semestri. Gjatë viteve të fundit anketimet janë bërë online ku rrreth 65 % e studentëve kanë plotësuar anketën. Të gjitha anketat janë përpunuar dhe rezultatet e tyre janë prezantuar në Departamentin e Financës dhe Ekonomiksit nga Pëgjegjesi i Departamentit.

Kontrolli i brendshëm i cilësisë


Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta:

Të tërthorta:

- Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve,
- Sondazhe të vlerësimit të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit;
- Pyetje konceptuale;
- Intervista;

Të drejtpërdrejta:

- Teste të standardizuara
- Dëgjime në auditor;
- Vlerësimi me pikë;
- Testime paraprake dhe përfundimtare; provime për module, praktikë;



- Vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët

Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel departamenti

KSBC-ja si strukturë direkte e menaxhimit të cilësisë ka përgjegjësinë kryesore për monitorimin e saj. Në kuadër të kësaj përgjegjësie kjo njësi realizon analiza vjetore të ecurisë së programeve të nivelit MP në Financë dhe problematikën e dalë. Në funksion të kësaj problematike instancat drejtuese në qëndër dhe ajo e njësisë bazë mësimore shkencore; parashtronë masat që duhen ndërmarrë për përmirësimin e procesit dhe rritjen e cilësisë.

Vetëvlerësimet e kryera dhe rezultatet e tyre


Institucioni analizon mbi bazë fakulteti dhe departamenti ecurinë e rezultateve lidhur me cilësinë e mësimdhënies nga gjithë metodat e brendshme që përdor institucioni si dhe duke përfshirë në to mendimin e përfaqësuesve të tregut të punës dhe opinionin e studentëve.

Politikat e përmirësimit të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike

Mbështetur në mendimin e personelit akademik, të anëtarëve të Bordit të Tregut të Punës (ngritur në nivel Departamenti) dhe opinionit të shfaqur nga studentët, kryesisht të atyre të organizuar në “fokus grupe” dhe pyetësorët online, institucioni programon politika dhe ndërmerr masa për zhvillimin e mëtejshëm të programeve të studimit, për të reflektuar në to zhvillimet bashkëkohore me karakter teorik si dhe kërkesat e tregut të punës lidhur me aspektin praktik.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.10 - Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve.	
Kriteri 1 Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;	KSBC organizon kontolle për proceset akademike që kontrollohen gjatë vitit dhe rezultatet e tyre i raporton në rektorat dhe dekanatet e fakulteteve.
Kriteri 2 Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin që bën për arritjen e sigurimit të brendshëm të cilësisë;	Vlerësimi i performancës së personelit akademik bëhet në mënyrë të vazdueshme dhe kontrollohet vazhdimisht nga Komisioni për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë(KSBC), i cili bën edhe rekomandimet e nevojshme për përmirësimin e kërkuar, në përputhje me objektivat, strategjinë dhe aktet rregullatore në fuqi.
Kriteri 3 Institucioni publikon rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;	KSBC harton cdo vit planin e veprimit te sigurimit të cilësisë. Ky plan përfshin komponentin e mësimdhënies, veprimtarisë shkencore dhe administrativ të cilësisë. Nga vlerësimi që ne i bëmë këtij plani të marrë gjatë vizitës në institucion, e gjykojmë të plotë dhe efektiv në përgjegjësinë e stafit akademik për cilësinë e komponenteve. Institucioni vlerëson veprimtarinë akademike dhe administrative me
Kriteri 4 Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta.	

	<p>metoda të têrthorta, sondazhe me studentët, për lëndët dhe pedagogët.</p> <p>Rezultatet e anketimeve dhe feed back i analizohen nga drejtuesit e institucionit, të fakulteteve dhe departamenti. Ato merren parasysh në performance e cdo pedagogu. Në fund të vitit akademik. Hartohen statistika për kalueshmërinë, notën mesatare, etj.</p> <p>Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të têrthorta ose të drejtpërdrejta.</p> <p><u>Të têrthorta:</u> Sondazhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve, sondazhe vlerësimi të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, pyetje konceptuale, intervista</p> <p><u>Të drejtpërdrejta:</u> Teste të standardizuara, Dëgjime në auditor, Vlerësimi me pikë; Testime paraprake dhe përfundimtare; provime për module, praktikë; Vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët, Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës</p>	
Standardi I.13 - Institucioni publikon rregullisht informacion të paanshëm dhe objektiv, sasior e cilësor, për vlerësimin e brendshëm.	<p>Kriteri 1 Institucioni publikon rregullisht broshura, buletine etj., të hartuara dhe botuara nga institucioni, për vlerësimin e brendshëm;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni publikon rregullisht prezantime në faqe interneti, video e audio etj. për vlerësimin e brendshëm.</p>	<p>Rezultatet e KBVC janë shpërndarë nga strukturat drejtuese për strukturat drejtuese, pedagogët dhe aktorët e tjera të interesuar.</p> <p>Këto rezultate diskutohen në nivel rektorati dhe në nivel departamenti e reagohet me masa konkrete.</p>
Standardi II.7 - Institucioni kryen një analizë vjetore për vlerësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.	<p>Kriteri 1 Institucioni harton një analizë vjetore për vlerësimin e ecurisë së programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni harton politika që synojnë përmirësimin e programeve të studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.</p>	<p>Cdo vit është bërë analiza e programit, duke synuar edhe reflektimin e tregut të punës, e opinioneve të tyre.</p> <p>Gjykojmë se rekondimet e dhëna nga GVJ(viti 2010) për përsosjen e programeve dhe planeve mësimore, mund të jenë objekt diskutimi jo vetëm brënda trupës akademike apo edhe duke u konsultuar me programe bashkekohore analoge, por edhe me aktorët e tregut, që iu shërbehet dhe synohet të zgjerohen., kjo nëpërmjet Bordit të Tregut të Punës.</p>
Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.	<p>Kriteri 1 Institucioni ka plotësuar standartet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përparrë aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;</p>	<p>UET sic u relata që në fillim të raportit, ka plotësuar standartet institucionale, është akredituar dhe riakredituar në nivel institucional.</p> <p>Programi i studimit në analizë është akredituar, për here të parë me Urdhër nr. 68, datë 14.02.2011</p> 

<p>Kriteri 3 Institucioni harton një politikë dhe ndjek procedura të caktuara për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të tyre;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimit;</p> <p>Kriteri 5 Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen, për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;</p> <p>Kriteri 6 Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.</p>	<p>Me synim orientimin më të mire drejt tregut, rritjen e nivelit shkencor e profesional, të gjitha strukturat bazë, departamenti, KBVC, e strukturat drejtuese kanë ndjekur në vazhdimësi rezultatet pas akreditimit të pare dhe rezultatet sasiore dhe cilësore janë në përmirësim.</p> <p>Në institucion funksionojnë strukturat, rregullat, procedurat dhe angazhimi për evidentimin e problematikave të programit, analizës së tyre, diskutimit e marrjes së masave si në vlerësimin e performances ashtu dhe rritjen e standardeve të cilësisë. UET ka hartuar politikat përkatëse të miratuara në Senatin Akademik dhe në nivel njësie kryesore dhe njësie bazë.</p> <p>Mekanizma të tillë si grupet e punës për probleme të veçanta, për format e kontrollit; pyetsoët me studentët aktualë dhe të diplomuar në UET, sistemin LMS etj, janë forma që janë aktive në procesin e cilësisë. Personeli ndërgjegjësohet përmes një larmie formash, nga trajnimi deri te rifreskimi i njouhurive mbi standartet dhe kërkesat e veçanta për cilësi Studentët njihen me kërkesat mbi cilësinë në UET me fillimin e vitit akademik.</p> <p>UET ka ndërtuar dhe synon sbatimin e një strategjie për sigurimin e vazhdueshëm të cilësisë, përmes veprimit tarisë së strukturave drejtuese, aktivitetit të KSBC.</p>
--	--

Konkluzionet e vlerësimit:

UET ka ndërtuar metodologji vlerësmi dhe organizma në shërbim të cilësisë si KBVC. Sigurimi i cilësisë në UET mbështetet nga strategjia e hartuar, strukturat e ngritura, larmia e procedurave të kontrollit, realizimi i transparencës dhe konsolidimi i KSBC. Veprimitaria e KSBC ka ardhur drejt konsolidimit dhe format e përdorura për kontrollin e brëndshëm të cilësisë po ashtu. Ka ndërgjegjësim dhe veprim konkret të të gjithë strukturave të UET në këtë drejtim. Nderkohë forma e anketimit duhet të jetë gjithpërfshirëse për të gjithë studentët, për më tepër që mundësistë e infrastrukturies online janë të disponueshme nga institucioni. Gjykojmë se KSBC tashmë e stabilizuar duhet të funksionojë në një afat mbi dy vjet për të garantuar rritjen e kualifikimit të njësisë dhe për të qënë një structure permanente funksionale dhe e mirëtrainuar.

Standarti plotësohet plotësisht

7. Programi i studimit, organizimi i tij

Pjesa përshkrimore

Terma reference: misioni dhe objektivi i programit të studimit, përbajtja e programit, organizimi i viti mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësish në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, etj

Programi i studimit Msc në Financë Bankë me profilet përkatëse është hartuar në mbështetje të objektivit, të përgatitjes së specialistëve të lartë me destinacion institucionet financiare dhe bankare.

Në ndërtimin e programit janë respektuar raportet dhe kriteret formale ndërmjet lendeve të formimit të përgjithshëm teorik, ato aplikative dhe ato të praktikave mësimore dhe temave të diplomës, Në funksion të profileve janë prezante në program edhe lendë me zgjedhje.

Për cdo lendë janë hartuar syllabuset përkatëse ku paraqiten objektivat e lëndës, detyrimet, literature bazë dhe ndihmëse dhe në disa lëndë kjo është e detauar edhe sipas temave, detyrimet e studentit, ngarkesa në orë leksione, seminare, punë të pavarur, detyrime gjatë vitit testi i ndërmjetëm, ai përfundimtar, pikët për sejcilin dhe pikët për detyrimet e tjera.

Programi Msc Finance-bankë me profile, përfshin njohuri teorike dhe praktike. Struktura e ndërtimit të programit synon të sigurojë katër grupe njohurish:

- aftësi metodologjike;
- aftësi teorike dhe aplikative;
- aftësi për profesionin përkatës,
- aftësi në profil më të ngushtë të fushës së studimit.

Diploma Master i Shkencave është konceptuar edhe një portë drejt studimeve doktorale dhe eksperiencës akademike. Programi Masteri i Shkencave në Financë Bankë me profile, ka 120 kredite ECTS me kohëzgjatje normale 2 vite akademike, në 4 semestra. Janë gjithsej 10 lëndë, praktika profesionale dhe punimi i diplomës. Nga këto 10 lëndë dy prej tyre domethënë 10% janë të karakterit të përgjithshëm (**kategoria A**), 7 lëndë ose 47% e programit përbëhet nga disiplinat e karakterit formues (**Kategoria B**), 2 lëndë të profitit 10% (**Kategoria C**), 1 lëndë ose 5% e kategorisë disiplina formuese të zgjedhura (**Kategoria D**), 10% praktika profesionale (**Kategoria E**) dhe 30% punimi i diplomës (**Kategoria F**). Për secilën lëndë zhvillohen 3 orë në javë nga të cilat dy orë leksion dhe një ore seminar. Frekuentimi i procesit mësimor (leksione, seminare, etj) është i detyrueshëm në masën 80%. Përsa i përket literaturës, bie në sy literaturë në gjuhë të huaj, ndërkohë që niveli i dijeve në këtë gjuhë pavarësisht rritjes së kritereve të pranimit, ka problem. Në përgjithësi janë respektuar format e kontrollit të njohurive të përcaktuara në silabusin e lëndëve si edhe me shënimet përkatëse rrith përgjigjeve të pyetjeve me zhvillim. Literatura e ofruar për studentët është e viteve të fundit e mbështetur në literaturën bashkohore.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e çdo programi studimi**

Programi Msc Financë-bankë me profile ofrohet në Fakultetin Ekonomik dhe të Teknologjisë së Infomacionit. Ai është licensuar me VKM Nr. 74 datë 21.01.2009. Programi i studimit është akredituar për herë të parë me Urdhër të MAS nr. 68, datë 14.02.2011 në përputhje me Vendimin nr. 133 datë 21.10.2010, të Këshillit të Akreditimit me vlerësim pozitiv me disa rekomandime.

Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)

Programi mbështetet në parimet e Kartës së Bolonjës, ka kohëzgjatje normale dy vite studimi, me 120 ECTS.

Ai është i organizuar në dy vite akademike, në katër semestra, 14 javë cdo semester, 28 javë mësimore në auditor.

- Plani mësimor sipas viteve akademike, ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë**

Referuar RVB plani mësimor i detauar sipas numrit të lendeve për semestër është paraqitur në (**Tabela 7Aneks**)

- Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit**

Referuar RVB dhe takimeve në institucion, treguesit e llogaritjes së krediteve janë :

1 ECTS = 25 orë mësimore punë të studentit.

Sipas planit mësimor ato janë ndarë në:

- leksionet 11 orë në auditor dhe 14 orë punë e pavarur e studentit
- seminarët 7 orë në auditor dhe 18 orë punë e pavarur e studentit
- projekt/detyra/ushtrime 12 orë në auditor dhe 13 orë punë e pavarur e studentit
- praktikë profesionale 21 orë në auditor dhe 4 orë punë e pavarur e studentit
- punim diplome 1 orë në auditor dhe 24 orë punë e pavarur e studentit.

Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara

Në krahasim me programin mësimor të licensuar janë bërë zëvëndësime në dy lëndë. Përkatësisht janë zëvëndësuar lënda “*Menaxhim Financiar*” me lëndën e disiplinës së përgjithshme “*Medotat e kerkimit të avancuar*”, si dhe lënda “*Analize financiare e avancuar*” e disiplinave të formimit tek profili “Banka” me lëndën “*Audit bankar*”.

Këto ndryshime janë mundësia maksimale për ndryshim në këtë duke zene një peshe specifike prej afro **17 % nga 20 %** qe eshte mundesa maksimale e ndryshimit.

(Tabela 8 në Aneks).

Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës

Në zhvillimin e programit nga PAE kundrejt PAK gjatë 3 viteve të fundit ka pasur prirje mjaft positive duke arritur ne mbulimin e programit ne vitin akademik aktual në rrëth 90 %. Bie në sy fakti, se nga viti në vit është rriut kontributi i PAE me grada e tituj ku dominon titulli profesor dhe professor i asocuar (**Tabelat 10-1, 10-2, dhe 10-3** në Aneks)

Emërtimi i Diplomës për programin e studimit është: Master i Shkencave në Financë –Bankë me profile; Banka dhe Tregje Financiare, dhe Ekonomi Financë

Plani mësimor sipas viteve akademike, ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë paraqitet në tabelën 8 në anekset e këtij materiali

Orët në Auditor paraqitur sipas formave të mësimdhënies (**Tabela 11 ne Anekse sipas RVB**).

Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë.

Një vend të vecantë në ndërtimin e programeve zë edhe ngarkesa mësimore dhe detyrimet e studentit që janë pjesë e cdo syllabli. Në mënyre unike sipas RVB ato paraqiten:

Format e kontrollit te njohurive	Pjesa në % ndaj totalit
Ndjekja e lëndës dhe pjesemarrja aktive	10%
Plotësimi i detyrimeve (laboratike detyrat e kursit)	20%
Testimet gjatë vitit	30%
Provimi përfundimtar	40%
Gjithsej	100%

Analizë e cilësisë së syllabuseve

Lidhur me syllabluset dhe cilësinë e tyre, gjykojmë edhe një here se në funksion të kërkesave, të tregut dhe objektivave dhe hapave të ndërmarrë nga institucioni, ato duhen rishikuar në funksion të rritjes së prezences së lëndëve financiare dhe manazheriale në drejtim të bizneseve konkrete dhe të ulet sëdopak

ofrimi i lëndëve kryesisht në nivelet makro, si ato të përshkruara në seksionie standardeve të planeve dhe programeve mësimore.

Duke ditur mundësitet e institucionit për udheheqje, fenomenet e vrejtura në ngarkesat në numur diplomash për pedagog, ngarkesat konkrete të cdo pedagogu dhe nevojën për sjellje më shume të praktikave të biznesit, punimet e diplomës duhen orientuar gjithashtu më shume në drejtimet e mësipërme.


Komponent i programit është edhe puna shkencore e studentëve. Krahas përgatitjes së diplomës, ata janë aktivizuar edhe ne punë shkencore pranë pedagogëve. Kështu numri i tyre sipas RVB i aktivizuar dhe atashuar pranë pedagogëve, është:


Aktiviteti shkencor i IAL	Numri i studentëve të aktivizuar
Për punime shkencore individuale të pedagogëve	9
Për projekte shkencore në rang Departamenti	3
Për projekte shkencore në rang Fakulteti	
Për projekte shkencore në bashkepunim me te tjera	

Duke patur parasysh faktin se kemi të bëjmë me master shkencor në Financë Bankë dhe profile disi intriguese në financat dhe bankat në nivele qëndrore gjykojmë së ky numur duhet rritur, po ashtu edhe konferencat shkencore me studentët që janë edhe një punë paraprake e tyre në funksion të diplomave të ardhëshme.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi I.1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
Kriteri 1 Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit European të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);	Programi Msc ne Financë me profile që ofrohet në UET është akredituar për herë të parë me Urdhër të Ministrit Arsimit dhe Shkencës Nr. 68, datë 14.02.2011.
Kriteri 2 Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;	Ai është organizuar sipas dispozitave të Ministrisë së Arsimit dhe lëndët e modulet vlerësohen me kredite ECTS. Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë programit Msc ne Finance nga një student që ndjek kete program studimi me kohë të plotë është 60 kredite
Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	
Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë "Master i Shkencave", "Master i arteve të bukurë" apo "Master Profesional" i pajisin studentët që zotërojnë diplomën universitare "Bachelor" me njohuri të thelluara, teorike dhe praktike, si dhe trajnim për kërkim shkencor apo trajnim të mirëfilltë professionale	Programi MSc. në Financë - Bankë ka synuar plotësimin me dije e formim në fushën e bankës dhe finances, ofron njohuri të thelluara teorike, praktike dhe profesionale, kryesisht në nivelin e sistemit bankar dhe të administratës fiskale. <i>Kërkohet zgjerim në fushën e bizneseve konkrete me njohuri aplikative e disiplina të lidhura drejtpërdrejt me to në aspektin e menaxhimit, finances dhe kontabilitetit e auditit. Gjykojmë se profilet e ofruara kanë pak dallime në lëndët që ofrojnë për të përligjur emërtimet e tyre Banka dhe Tregje Financiare dhe Ekonomi Finance</i>
Kriteri 3 Programet e studimeve "Master i Shkencave" ose "Master i arteve të bukurë" dhe "Master Profesional" synojnë të zgjerojnë njohuritë e fituara në ciklin e parë të studimeve;	<i>Programi është mbështetur në njohuritë në sistemin bachelor, duke prezantuar shkurt nocionet bazë për të</i>
Kriteri 4 Programet e integruar të studimeve të ciklit të dytë (në mjekësi, stomatologji, farmaci, veterinari, arkitekturë) i pajisin studentët me njohuri të thelluara dhe	

<p>kompetencia shkencore, teorike dhe praktike, si dhe trajnim përkërmim shkencor sipas fushës. Pas përfundimit të tyre si dhe përfundimit me sukses të provimit të shtetit për programin specifik, studentët fitojnë të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar sipas ligjit në fuqi</p>	<p>akomoduar edhe avancimin e studentëve që nuk kanë përfunduar studimet bachelor në këtë fushë.</p>
<p>Kriteri 5 Programet e studimeve të këtij cikli i pajisin studentët me kompetenca të përgjithshme dhe profesionale që synohen të arrihen apo të zgjerohen gjatë zhvillimit të tij;</p>	<p>Objektivi i programit është të formojë ekspertë dhe specialistë në aspektet teorike edhe aftësitë praktike aplikative në tregjet financiare, bankat, sigurimet dhe politikat e sistemet fiskale.</p>
<p>Kriteri 6 Programet e studimeve "Master i Shkencave" ose "Master i arteve të bukurë" dhe programet e integruar të studimeve të ciklit të dytë krijojnë baza të qëndrueshme njojurish për studimet e ciklit të tretë doktoratës, duke përfshirë aftësimin përkërmim shkencor dhe plotësimin e parakushteve (njojuri, aftësi dhe kompetenca) për pranimin në ciklin e tretë të studimeve;</p>	<p><i>Gjykojmë se edhe për nivelet që synohet mungojnë disiplina si drejtimi bankar, drejtimi i organizatave publike, financa publice apo taksimi i biznesit, e auditimi që lidhen për më tepër me drejtimet ku synohet të orientohen studentët dhe dominojnë disiplina që lidhen me tregjet financiare, menaxhimin e institucioneve financiare, etj që për kushtet e vendit tone janë në fazë ta pazhivilluara. Vecanërisht janë të mundura prezenca e tyre me fleksibilitetin që ofrojnë profilet sidomos ai banka dhe tregje financiare dhe më pak ai ekonomi-finance që na duket shumë i përgjithshëm.</i></p>
<p>Kriteri 7 Programet e studimeve "Master Profesional" kanë objektiva të qartë profesionalë, të justifikueshëm, të arritshëm, me synime të qarta për arritjen e kualifikimit të nevojshëm dhe në përputhje me kërkuesat e tregut të punës.</p>	<p>Programi i studimit përbën një hap të nevojshëm për ciklin e tretë të orientuar kryesisht në nivele makro dhe për institucionet financiare dhe bankare. Ai ka ofruar njojuri, aftësi dhe kompetenca dhe metodologji përkërmim shkencor, për më tepër që janë të pranishme disiplina si ekonometri apo metoda të avancuara kërkimi. Këto cilësi përbëjnë një bazë të mire për avancimin në studime të ciklit të tretë të doktoratës.</p>
<p>Standardi I.4 - Programet e studimeve ofrohen në përshtatje me nivelin e studimeve.</p>	
<p>Kriteri 1 Përbajtja dhe renditja e objektivave të programave të studimeve synojnë arritjen e qëllimeve të tyre në përputhje me nivelin e studimeve në të cilin ofrohen ato;</p>	<p>Programi i studimit, lendet që ofrohen për nga niveli i kanë përbushur kriteret shkencore për ciklin e dytë, integrohen e mbështesin njëra tjeter, pavarësisht nga rezervat dhe rekomandimet tona për ndryshime në finkcion edhe të objektivave të tregut të vetë UET.</p>
<p>Kriteri 2 Metodat e vlerësimit të studentëve nëpërmjet kontrollit të vazhdueshëm të njojurive me anë të testeve me përgjigje alternative apo provimeve përfundimtare dëshmojnë ecurinë dhe arritjet e studentëve për ciklin përkatës të studimeve.</p>	<p>Studentët janë vlerësuar gjatë vitit dhe testit përfundimtar duke alternuar edhe element të tjera detyrimi, eseja dhe aktivizimi në diskutime në klasë. Përgatitja e esesë ka përqëllim të zhvillojë aftësitë e studentëve për të argumentuar, analizuar, gjykuar, menduar në mënyrë kritike dhe shkruar duke shfrytëzuar formimin e tij bazë dhe njojuritë në lëndën përkatëse.</p>
<p>Standardi I.5 - Programet e studimeve synojnë të arrijnë dimensione ndërkombëtare.</p>	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve mbështeten në përvojën disavjeçare dhe praktikat e mira të vendeve europiane;</p>	<p>Programi ka reflektuar arritjet dhe eksperiencën e UET, me piksynim tregun e institucioneve financiare e bankare, duke u konsultuar edhe me programe bashkekohore.</p>
<p>Kriteri 2 Programet e studimeve janë ndërkombëtarisht konkuruese për nga elementet që përbajnë (të dhëna të përgjithshme, objektivat kryesorë, plani mësimor, kreditet, kushtet e pranimit në tometodat e vlerësimit, kriteret dhe procedurat e transferimit të krediteve e njojurive të fituaara, diplomat që jepen në përfundim etj.) duke afirmuar vlerat e arsimit universitar në Shqipëri;</p>	<p>Programi i studimit përmban elementët bazë që lehtësojnë njojen dhe ekuivalentimin e diplomës jashtë vendit. Ka pasur studentë të cilët kanë nisur studimet në këtë program dhe më pas i kanë vazduar ato në universitetet jashtë vendit duke ju njojur një pjesë të mirë të lëndëve të ndjekura në UET.</p>
<p>Kriteri 3 Programet e studimeve janë hartuar në përputhje me objektivat e përcaktuar në legjislacionin dhe direktivat e BE-së për arsimin e lartë dhe profesionet e rregulluar.</p>	

	<p>Programi i studimit respekton direktivat e BE dhe Kartën e Bolonjës përsa i përket strukturimit, raportit midis disiplinave, numrit të krediteve, elementeve të detyrimeve, javëve në auditor e jashtë tij, si dhe me profesionet e rregulluara.</p>
Standardi I.6 - Programet e studimeve përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë përfshijnë aftësimin profesional dhe kërkimin shkencor;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve hartohen në përputhje me profilin e Institucionit të Arsimit të Lartë dhe strategjinë e tij për zhvillim;</p> <p>Kriteri 3 Personeli akademik angazhohet në punën kërkimore shkencore për realizmin e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Puna kërkimore e personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimeve përkon me synimet për arritjen e qëllimeve të tij.</p>	<p>Ashtu siç kemi theksuar më lart, programi i studimit përfshin aftësim profesional dhe kërkim shkencor. Aftësimi profesional i studentëve realizohet jo vetëm përmes praktikës profesionale, e cila kryhet gjatë semestrit të dytë, por edhe përmes lëndëve me karakter aplikativ që ofrohen në programin e studimit. Edhe aftësimi për kërkim shkencor realizohet përmes lëndëve të metodologjisë, seancave metodologjike për punimin e diplomës dhe konsultimin e vazhdueshëm me pedagogun udhëheqës.</p> <p>Programi i studimit është mbështetur dhe mbështet strategjinë e zhvillimit të UET-it misionin e tij dhe drejtimet e miratuarë për kërkimin shkencor.</p> <p>Edhe angazhimi në punë shkencore është orientuar nga fushat akademike dhe interesat e pedagogut, departamentit dhe objektivat e institucionit. Sic e kemi theksuar më pare, këto janë pjesë e detyrimeve dhe kontratës, së nënshkruar me UET.</p> <p>Në UET është respektuar liria akademike dhe shkencore por synohet të orientohet krijimtaria edhe në funksion të interesave të institucionit. Mbështetur në vleresimet periodike që bën institucioni personeli akademik angazhohet në punën kërkimore jo vetëm në interes të ecjes përpara profesionalisht, por dhe për të përmbushur detyrimet sipas kontratës së nënshkruar me UET. Rritja e punës së tyre kërkimore shkencore i shërben edhe rritjes cilësore të mesimdhenis ne kete program.</p>
Standardi I.7 - Programet e studimeve "Master Profesional" ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve të ciklit të dytë "Master Profesional" ofrohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të dytë "Master Profesional" synojnë të plotësojnë nevojat në sektorët përkatës të ekonomisë vendase apo të huaj.</p>	N/A
Standardi I.8 - Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve marrin parasysh nevojat e tregut të punës, dhe hartohen në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një studim tregu, i cili përfshin:</p> <ul style="list-style-type: none"> a. mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, komëtar ose ndërkombëtar; b. kërkjesat e punëdhënësve; c. një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program; d. numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra. 	<p>Tregu i punës përfaqësuar nga institucionet financiare, bankare, të sigurimeve, etj janë bazë permanente që ka orientuar programet dhe planet mësimore. Gjykojmë se pavarësisht hapave dhe progresit, rekomandimet e Bordit të Tregut të Punës, ku bëjnë pjesë përfaqësues të kompanive më në zë të sektorit, kërkohet të pasqyrohen më mire në programet e lëndëve dhe në gamën e lëndëve me zgjedhje që ofrohen.</p> <p>Edhe mendimi dhe opinion i studentëve të punësuar është me vlerë</p> 

	Gjykojmë se pavarësish hapave të arritur dhe interest të UET për tregun, një studim i plotë tregu për nevojat sot dhe në perspective duke pare dhe zhvillimet e konkurrencës, konfiguron më mire drejtimet e studimit, profilet dhe ndërtimin e curriculave që mbetet detyrë në vazhdimësi për këtë institucion dhe program në funksion të objektivave strategjike dhe peshës që synon të ketë në treg.
Standardi I.9 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.	
Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interest kombëtare;	Programi i studimit ofron specialist tregu financiar dhe bankar, zhvillimi dhe fuqizimi i të cilave mbështet interesat dhe zhvillimin ekonomik kombëtar. Ai zhvillohet duke patur focus ambientin ekonomik dhe legjislativ shqiptar, pra mbështet ruajtjen dhe zhvillimin vlerave kulturore kombëtare.
Kriteri 2 Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.	
Standardi I.12 - Kohëzgjatja dhe numri i krediteve për programet e studimeve të këtij cikli janë në përputhje me me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.	
Kriteri 1 Programet e studimeve "Master i Shkencave" realizohet me 120 kredite europiane ECTS, ku përfshihen 30-40 kredite europiane ECTS për projektin kërkimor dhe tezen që duhet përgatitur në përfundim të këtyre programeve të studimeve. Kohëzgjatja normale e tyre është 2 vite akademike;	Programi i studimit realizohet me 120 kredite europiane ECTS, ku projekti kërkimor dhe teza përfshin 36 kredite . Kohëzgjatja normale e programit është 2 vite akademike. Bazuar në metodologjine e përcaktimit të krediteve si dhe në mjaft eksperiencia të programeve në universitetë të tjera numri i krediteve mund të jetë i ndryshëm për lëndë të ndryshme. Kjo rrjedhojë e vështirësisë apo orëve të angazhimit jashtë auditorit që për lëndë të veçanta mund të janë më shumë se për disa lëndë të tjera. Ky "uniformitet" në përcaktimin e krediteve për të gjitha lëndët e programit barazon notën mesatare të llogaritur si mesatare e thjeshtë me notën mesatare të llogaritur si mesataren e ponderuar me kreditet. Ndonse respektohet ky kriter përsa i përket numurit të krediteve sipas standardeve, mbështetet përfshin numrave 25 apo 30 e numurit të krediteve për punimin e diplomës do krijonte hapsirë orësh dhe kreditesh për disiplina bazë apo me zgjedhje në funksion të drejtimeve të programit. Ka mjaft modele që e përligjin këtë. Për më tepër që situate edhe mundësitë e mentorimit ciësor të 10-20 diplomave për pedagog e kushtëzojnë këtë,
Standardi II.6 - Institucioni siguron menaxhimin efikas të informacionit në lidhje me programet e studimeve.	
Kriteri 1 Informacioni i ofruar për programet e studimeve, modulet dhe syllabuset është lehtësish i konsultueshem për studentët;	Programi i studimit, me lëndët përbërëse të tij, sipas viteve dhe semestrave është i publikuar në faqen e internetit të UET-it. Studentët në fillim të cdo semestri pajisen me të gjithë silabuset e lëndëve.
Kriteri 2 Informacioni për programet e studimit, modulet dhe syllabuset ofrohet në formë të ndryshme të shkruara dhe elektronike.	Informacioni mbi programet syllabuset, është pjesë e platformës LMS, ku çdo student sheh gjithë materialet e lëndës që pedagogët vendosin në portal, krahës silabusit.

	<p>Herë pas here departamenti në mbledhje të hapur me studentët, diskuton aspekte të proçesit mësimor tërhiqen mendime për cështje të programit, rregullores.</p> <p>Ne sistemin online dhe ato që u pëershruan më pare ka akses cdo student për të gjithë elementët dhe materialet mësimore të programit.</p>
Standardi II.8 - Programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruarat e studimeve të ciklit të dytë parashikojnë një plan diplomimi.	
<p>Kriteri 1 Plani i diplomimit shpjegon mënyrën e diplomimit në përfundim të studimeve brenda afatit të parashikuar;</p> <p>Kriteri 2 Për realizimin e programeve të studimeve “Master i Shkencave” janë parashikuar 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe tezën.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, konstatuan se studenti ka instrukcionet, konsultën dhe informacionin për temën e diplomës, fushat e interest. Propozimi dhe caktimi i temave dhe njoftimi public janë procedura që ndiqen ne UET, dhe studenti ka aksesin e nevojshëm Ai ndjek përgatitjen e diplomës, sipas udhëzimeve të departamentit dhe udhëheqësit shkencor.</p> <p>Për punimin e diplomës studenti vlerësohet me 36 kredite.</p> <p><i>Mbetet problem numuri i lartë i temave për pedagog, që cenon cilësinë, dhe niveli i gjuhës së huaj nga studentët.</i></p> <p>UET ka bërë përpjekje dhe ka akses për informacion studimor e kërkimor në institucionet ku e cakton studentin për praktikë, që përgjithsisht lehtëson edhe përgatitjen e diplomave. Departamenti bën séance dhe udhëheqje metodike të diplomave, trainim e instruktim mbi rregullat e shkrimit akademik, dhe ndjek hap pas hapi progresin në përgatitjen e diplomës.</p>
<p>Konkluzionet e vlerësimit:</p> <p>Sipas vizitës në institucion, analizës e vëzhgimit tone dhe RVB, programi i studimit Msc finance-bankë dhe profilet e tij synojnë dhe kontribuojnë në objektivat e institucionit dhe departamentit, për nga mënyra e ndërtimit, raportet midis lëndëve, pesha e tyre etj, respekton kriteret sipas kërkësave të legjislacionit në fuqi. Studentët kanë akses dhe janë të informuar për të gjitha detyrimet e programit, materialet baze, të drejtat dhe detyrimet. Sipas RVB këto programe u dërgohen elektronikisht nga koordinatorja e departamentit, vendosen në sistemin LMS, dhe gjenden të printuara në librarinë e universitetit. Eshtë synuar një ngarkesë normale e barabartë, harmonike dhe mbështetëse e lëndëve nga viti në vit, me anë të unifikimit të kreditave.</p> <p>Kërkohet një studim më i plotë i tregut të punës, përfshirja e ecurisë së konkurentëve në këtë studim, nevojat specifike të bizneseve, dhe mbi këtë bazë korigimet e përsosjet e nevojshme të programeve dhe syllabluseve si dhe diferencimi i peshës në kredite për lëndët bazë të formimit të përgjithshëm, professional dhe ato të profitit duke synuar edhe me shumë lëndë me zgjedhje qoftë edhe në sistemin e moduleve.</p> <p>GVJ vlereson se standarti plotësohet kryesisht</p> <p>Rekomandim:</p> <ul style="list-style-type: none"> ❖ <i>Të rishikohet pesha dhe numri i kreditave për çdo lëndë në varësi të orëve mësimore, kontributit në formimin e studentit, plotësimi i rekomandimeve për rishikim programesh do sjellë edhe rishikimin e peshës së çdo lënde të formimit të përgjithshëm, bazë, ato të profitit, etj duke hequr kriterin unifikues pavarësisht problemeve që mund të sjellë në menaxhimin e procesit mësimor.</i> ❖ <i>Të rishikohen sullabluset e disa lëndëve që gjinden në të dy programet se janë të njëjta. Ne funksion edhe te objektivave te ketij programi ne syllabus mund te reflektohen ndryshimet krahasuar me zhvillimin e te njejtes lende ne programin Msc ne Finance Banke.</i> 	

- ❖ Duke shqyrtuar planin mesimor veme re që në të janë percaktuar numer i njëjtë kreditesh per te gjitha lendet që eshte 6 ECTS. Bazuar ne metodologjine e percaktimit te krediteve si dhe ne mjaft eksperiencia te programeve ne universitetet te tjera numri i krediteve mund te jete i ndryshem per lende te ndryshme. Kjo rrjedhoje e veshtirese apo oreve te angazhimit që per lende te veçanta mund te jene me shume se per disa lende te tjera. Ky "uniformitet" ne percaktimin e krediteve per te gjitha lendet e programit barazon noten mesatare te llogaritur si mesatare e thejshte me noten mesatare te llogaritur si mesataren e ponderuar me kreditet.
- ❖ Ne grupin e lendeve karakterizuese mendojme se mund te perfshihen lende qe tashme trajtohen gjeresisht si të tilla ne eksperiençen e shume vendeve apo universitetet e njoitura si: "Drejtim Portofoli", apo Drejtim Financiar i Avancuar" dhe lende te tillë ne kete grup si "Banka Qendore dhe Politika Monetare" apo Politikat Ekonomike Financiare" te vendoseshin si lende me zgjedhje. Hapesira e trajtimit te tyre mund te gjindet edhe po të shikohen mbivendosjet qe kane lendet: " Tregjet e Kapitalit dhe Institucionet Financiare"; "Menaxhimi i Institucioneve Financiare" dhe Tregu Bankar dhe Institucionet e tij

8. Mësimdhënia

Terma reference: organizimi i mësimdhënieve, format e mësimdhënieve, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njojurive të studentëve, metodat e mësimdhënieve, teknologjite e mësimdhënieve, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënieve, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.

Procesi mësimor organizohet në grupe mësimore me 50-60 studentë. Ky program zhvillohet me: leksione, seminare, leksion/seminare, punë laboratorike, detyra kursi, provime të ndërmjetme, provime përfundimtare, praktika profesionale dhe punim diplome.

Ndarja e lëndëve në simestra është e parashikuar në planin mësimor, pervec rastit kur ka patur spostime nga njëri semester në tjetrin. Në organizimin e mësimdhënieve janë patur parasysh renditja e lëndëve duke filluar nga ato të formimit të përgjithshëm, në ato të profilit, ballancimi i ngarkesës, për studentët dhe sigurimi i ngarkesës për stafin akademik të brendshëm, sipas kontratës. Për kriteret e ngarkesës, shpërndarjen e saj dhe problemet që lidhen me të UET, ka një document të vecantë që rregulon këto cështje.

Në programin e studimit, janë përfshirë:

- Disiplina të formimit të përgjithshëm/bazë
- Disiplina të formimit karakterizues të programit
- Disiplina të ngjashme dhe/ose integruese
- Disiplina të zgjedhura
- Veprimtari formuese për njojje të gjuhëve të huaja, aftësime kompjuterike, praktika
- Përgatitja e tezës së diplomës

Për cikle leksionesh/module brenda lëndëve të kategorive A dhe B, janë ftuar ekspertë, profesorë të shquar të fushës. Monitorimi i mbarëvajtjes së procesit mësimor bëhet nga nga sekretaria mësimore, që mban evidencat për zhvillimin e orëve të mësimit, raporton për orët e pazhvilluara, tek sekretari i përgjithshëm, tek dekanët e fakulteteve dhe tek zyra e burimeve njerëzore. Dekani dhe përgjegjësi i departamentit në bashkëpunim me Sekretarinë Mësimore monitorojnë zhvillimin e procesit mësimor në përputhje me orarin.

Për vlerësimin e cilësisë së mësimdhënieve bëhet me anë të leksioneve të hapura, nga studentët, vetëvlerësimi, nga dekani e përgjegjësit e departamenteve, nga grupi ad.hoc, i ngritur me urdhër të Rektorit.

Në fund të cdo viti , bëhet vlerësimi nga Komisioni i Vlerësimit të Performancës që ngrihet nga Rektori, I quajtur follow up (follow-up). Rezultatet e përpunuara u bëhen me dije personelit akademik të interesuar dhe autoritetet e drejtuese. Përgjithsisht respektohen standartet e brendshme për cilësinë e organizimit të lëndëve, zgjedhjen e literaturës si dhe mjeteve e metodave të larmishme didaktike të përdorura gjatë leksioneve dhe seminareve.

Vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm. Kontrolli i njojurive zhvillohet nëpërmjet formave të percaktuara nga Universiteti: provim/ese,

pjesëmarrje në seminare apo kolokiume në varësi të tipologjisë së përcaktuar të lëndëve. Korrigimi zhvillohet në përputhje me udhëzimet dhe rregullat e Universitetit.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet janë (Tabela 11 në Aneks):

• Leksione	376 orë
• Seminare	168 orë
• Ushtrime	216 orë
• Praktikë profesionale	255 orë
• Punimi i diplomes	20 orë

Format e kontrollit të njohurive (Tabela 12 në Aneks)

- Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive. Specifikuar në syllabuset përkatëse
- Plotësimi i detyrimeve (detyrave të kursit), Specifikuar në syllabuset përkatëse
- Testimet gjatë vitit, Specifikuar në syllabuset përkatëse
- Provimi përfundimtar, Specifikuar në syllabuset përkatëse
- Etj; të specifikuar në syllabus

Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj

Në verifikuam qe studentët e programit Msc në Financë kanë marrë pjesë në evenimente të organizuara nga Departamenti i Financës dhe Ekonomiksit. Aktivitete të tillë kanë përfshire seminare, konkurse, samite apo forume të organizuara nga UET-ja. Disa të dhëna paraqiten më poshtë: (Tabela 13 në Aneks)

9. Studentët

Pjesa përshtkimore

Termi reference: procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.

UET ka ndërtuar një sere kriteresh dhe dokumentash për pranimet e reja, për transferimet në hyrje dhe ecurinë e studimeve, Ato synojnë përgjedhje për aq sa është e mundur.

Pranimi i studentëve në programin MSsc në Financë që ofrohet nga UET bazohet në kuadrin ligjor dhe rregullativ në fuqi si dhe në kriteret dhe procedurat e përcaktuara nga institucioni. Gjatë vizitës në institucion ne verifikuam me zgjedhje procesin e regjistrimit të studentëve në këtë program duke parë përbajtjen e dosjeve të studenteve të regjistruar. Në dosjen e regjistrimit gjendeshin dokumentet e plotësuara të mëposhtme:

- Formulari i interesimit
- Kopje e noterizuar e diplomës të ciklit të parë që studenti ka fituar;
- CV-në e kandidatit, ku paraqiten të dhëna biografike dhe të eksperiencave profesionale.
- Një Letër Interesi (afersisht 500 fjalë) ku paraqiten objektivat profesionale, interesat kërkimore dhe nxitjet për të kryer studimet e ciklit të dytë.
- Një projekt-ide ku paraqiten interesat e tij shkencore gjatë programit.
- Dy letra rekomandimi të cilat garantojnë kompetencën profesionale, përgatitjen akademike dhe mundësinë e kandidatit për të kryer studimet në këtë nivel.
- Paraqitura e një dokumenti që tregon aftësitë e kandidatit në njohjen e një gjuhe të huaj përbën avantazh.

Të gjitha dokumentet e mësipërme dorëzohen në Zyrën e Kontratave. Pas vlerësimit formal të listës së dokumenteve të nevojshme, dokumentacioni i kalon Departamentit përkatës i cili bën vlerësimin e aplikimeve dhe harton listën e kandidatëve të përgjedhur. Çdo kandidat i përgjedhur zhvillon një intervistë në Komitetin Shkencor të programit rreth projektit të zhvillimit të karrierës, në përputhje me fushën e studimit. Sekretaria mësimore e UET-se disponon statistika të detajuara vjetore për numrin e të diplomuarve për çdo program dhe cikël studimi në bazëviti akademik.

Aplikimi ndjek procedurat duke u përgjedhur nga departamenti dhe nga Komiteti Shkencor i programit Numri i pranimeve bazohet në mundësitetë reale të çdo fakulteti të UET-it për mësim normal dhe brenda standardeve të këruara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, në përputhje me Ligjin nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Rregulloren dhe Statutin e UET-it.

UET ofron lloje të ndryshme bursash, si:

- a. bursa sociale për shtresat në nevojë siç janë dhe bursat PASHKO,
- b. bursa të pjesshme për maturantët që kanë përfunduar shkollën e mesme me mesatare mbi 9.2 dhe 9.5
- c. burse ekselence për studentët me rezultate të larta gjatë studimeve në UET
- d. bursë lidershipi dhe
- e. bursa VIP për persona të njohur për arritje në fushën e artit, sportit, etj.

Bursa te akorduara 2015-2017 per ciklin e studimeve Master (Sipas RVB)

Bursa sipas ciklit te studimit	2015-2016	2017-2018
MP	38	15
MSh	88	73
Total	126	88

Vihet re se numuri i studentëve në master shkencor me bursa ka qëndruar në nivele të larta në vitin 2016-2017 prej 73 studentë, ndaj 88 një vit më parë, krahasuar me renien e ndjeshme të këtij numri në masterin profesional prej 15 studentë në 2015-2016 kundrejt 38 të një viti më parë Për studentët MSc në Financë Banke, janë akorduar 18 bursa në vitin 201-2016 dhe 12 bursa në vitin 2016-2017

Për studentët MSc në Financë Banke, janë akorduar 18 bursa në vitin 2015-2016 dhe 12 bursa në vitin 2016-2017.

Gjatë vizitës në sekretarinë mësimore në regjistra u konstatuan studentë pa numra matrikullimi, kryesekretarja e argumentoi këtë fakt si vonesa të AKP konkretisht:

- Për vitin 2015-2016 rezultonin pa numër matrikullimi 16 studentë
- Për vitin 2016-2017 rezultonin pa numër matrikullimi 3 studentë
- Për vitin 2017-2018 rezultonin pa numër matrikullimi të gjithë studentët

Punësimi i studentëve.

Në Universitetin European të Tiranës, funksionon shoqata Alumni.që mban kontakte me ish studentë. Alumni ndihmon studentët dhe të diplomuarit e UET për karierën e tyre. UET organizon Panairin e punës. Programi +250 dhe ALUMNI krijojnë kontakte me industrinë dhe organizata të ndryshme për kurset dhe internshipet me kredite.

Në funksion të lidhjes së studentëve me tregun funksionojnë dhe Bordet e Tregut të Punës. Për kontaktet me vendet e punës në UET shërben edhe follow up i përvitshëm.UET ka database për kontaktet, për aktivitete për cilësinë dhe shërbimet ndaj studentëve Në UET funksionon edhe Zyra e Kujdesit ndaj Studentit. Sic u pranua edhe nga GVB, ka shkallë të ulët përgjigje.Në programin Msc. Financë – Bankë shkalla e mospërgjigjes studentëve në dy vitet e fundit varion nga 45-47%. Lipset të gjenden mënyra për sigurimin e të dhënave, që ato të janë përfaqësuese dhe të karakterizojnë drejt

shkallën e punësimit të studentëve. UET aplikon edhe çmimin e karierës çdo vit për ish studentin me karierë më të suksesëshme.

Vlerësimi i Tregues të matshëm:

Procedurat e pranimit të studentëve

Procedura e pranimit te studenteve në programin Msc në Financë me profile bazohet krasas bazës ligjore dhe akteve nenligjore edhe në rregullat e brendshme te UET-së (me hollesisht shih me siper)

Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve

Gjatë vizitës në insitucion u kërkuau të dhëna mbi notën mesatare hyrëse dhe dalëse të studentëve. Ky dokument na u vu në dispozicion nga specialistja e ASCAL. Cilësia e hyrjes dhe daljes të studentëve në Msc Financë Bankë e shohim kryesisht në notën mesatare të programit bachelor e cila varion në vite nga 5.2 deri në 10. Ky varacion ka të bëjë me faktin se nuk ka patur kritere strikte në vendosjen e një note mesatare dysheme poshtë të cilës të mos kishte të drejtë regjistrimi kandidati për Msc. Nga shqyrtimi i notës mesatare të hyrjes të studenteve të ketij programi vëmë re që për tre vitet akademike te fundit ajo ka patur një stabilitet në tre vitet..

2015-2016 nota mesatare në hyrje 7.06

2016-2017 nota mesatare në hyrje 7.04

2017-2018 nota mesatare në hyrje 7.08

Cilësia në dalje e studenteve që kanë përfunduar studimet në këtë program shihet në noten mesatare të daljes. Vëmë re që nota mesatare në dalje për tre vitet e fundit ka patur luhatje, nga 7.22 ne 2014-2015 në 6.89 në dalje për 2016-2017. Parë në tërsi konkludojmë se në këtë program cilesia e një pjese të numrit të studenteve të regjistruar duhet konsideruar relativisht e ulët.

2014-2015 nota mesatare në dalje 7.22

2015-2016 nota mesatare në dalje 6.96

2016-2017 nota mesatare në dalje 6.89

Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë).

Duke shqyrtuar rregjistrimet ndër vite nga 2011 deri sot ka një luhatshmëri rregjistrimesh per nga numuri, nga 109 ne 2011 në 148 në 2013 në 96 në 2017. Po ashtu luhatshmëri ka edhe numri sipas profileve. Kështu në profilin Financë dhe Tregje Financiare nga 22 në 42 dhe Ekonomi finance nga 87 në 50, përkatësisht për vitet 2011 dhe 2017. Ndërkohë edhe notat më të ulta dhe më të larta shtrihen në diapazonin 5.3 deri 9.5

Të dhënat jepen në (**Tabelën 14** në Aneks)

Numri total të diplomuarve

Numri total të diplomuarve, ky numur sipas viteve eshte nga 14 ne 2011 ne 76 ne 2016. Per me hollesisht (**shih tabela 15 anekset**)

Numri total i të punësuarve (në përputhje me diplomën)

Po sipas tabeles 15 nga 7 te punesuar sipas diplomes ne 2011, ky numur eshte 36 persona ne 2015-2016

Numri total i të punësuarve (jo në përputhje me diplomën)

Ne vitin 2011 ishte 1 person dhe ne 2015-2016 eshte 10 persona

Të dhënat jepen në (**Tabelën 15 në Aneks**)


Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Institucionit ju kërkuan dokumente shtesë lidhur me numrin e studentëve të regjistruar, diplomuar dhe notës mesatare, të cilat na u vunë në dispozicion dhe janë paraqitur në këtë raport.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi IV.1 - Studentët kanë të drejtë të ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruarat e studimeve të ciklit të dytë.	
Kriteri 1 Studentët që ndjekin programet e studimeve "Master i Shkencave" apo "Master Profesional" zotërojnë së paku diplomën universitare "Bachelor" dhe kanë grumbulluar 180 kredite ECTS;	Për Msc Financë- Bankë nga verifikimi me zgjedhje që ne bëmë pranë sekretarisë mësimore konstatuan se regjistrohen studentët, me diplomë bachelor me 180 kredite, ose diplomë të sistemit të vjetër 4 vjeçare.
Kriteri 2 Pranimi në programet e integruarat e studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe akteve nënligjore në fuqi;	Studentët janë përgjedhur duke respektuar kërkosat e ligjit 9741 të Arsimit të Lartë që aplikojnë, skemës, kritereve dhe rregullave të UET, përgjidhen sipas kritereve të UET, sipas legjislacionit.
Kriteri 3 Studentët plotësojnë kriteret e pranimit të përcaktuara nga institucioni;	Studentët janë përgjedhur duke respektuar kriteret e institucionit, ku nota mesatare është ndër kryesorët.
Kriteri 4 Studentët e këtyre programeve të studimit japid deri në diplomim edhe provimin e gjuhës angleze mbi bazën e testeve të njohura ndërkombëtare. Për programet e studimeve "Master Profesional" niveli i gjuhës angleze është B2, ndërsa për programet e studimeve "Master i Shkencave" dhe programet e integruarat e studimeve të ciklit të dytë niveli i gjuhës angleze është C1, sipas Kuadrit European të Gjuhëve;	<i>Bazuar ne te dhenat e marra nga institucioni verejme se gjate 3 viteve te fundit ka pasur edhe mosrespektim te kriterit te notes mesatare ne hyrje per studentet. Nga keto te dhena rezulton se ka pasur student te regjistruar edhe me note mesatare 5 dhe 5.1 apo 5.2.</i>
Kriteri 5 Institucioni vlerëson herë pas here politikat e pranimit dhe ndikimin e tyre në përparimin e mëtejshëm të studentëve në programin e studimit, si dhe harton plane të mundshme për ndryshimin e kritereve të pranimit.	Po ashtu eshte respektuar kriteri i gjuhës së huaj ku mbizotëron gjuha angleze.
	Politikat e pranimit të studentëve kanë ardhur duke u përmirësuar. Eshtë rritur niveli minimal i notes pranimit pavarësisht nga vështirësitet që ka sjellë për sigurimin e kontigjentit të pranimit. Tregu dhe shpërndarja e studentëve në të gjithë spektrin universitar, kanë diktuar disi kriterin minimal

	të notes mesatare, sipas matures shtetërore.
Standardi IV. 2- Institucioni informon studentët në lidhje me: statusin e institucionit, të programeve të studimeve që ofron dhe me politikat e punësimit.	
Kriteri 1 Studentëve u jepet informacion për mundësitë për punësim pas diplomimit në përfundim të këtyre programeve të studimeve;	Studentëve të programit u ofrohet informacioni i nevojshëm nga institucioni lidhur për mundësite e punësimit në përfundim të programit nëpërmjet Zyrës së Karrierës, Bordeve të Tregut të Punës, Panaireve të Punës, etj. UET mban lidhje me punëdhënësit, që t'u sigurojë studentëve mundësi punësimi.
Kriteri 2 Studentëve u jepet informacion për akreditimin e institucionit dhe të programeve të studimeve që ofrohen si edhe për njohjen dhe vlefshmërinë, brenda dhe jashtë vendit, të diplomës së lëshuar nga ky institucion	Studenteve të programit që në momentin e aplikimit dhe regjistrimit informohen për statusin e akreditimit të programit dhe mundësive të njohjes së diplomës brenda dhe jashtë vendit. Strukturat e UET si Zyra e Karrierës, Bordet e Tregut të Punës, Panaret e punës janë shfrytëzuar dhe kanë ndikuar në këtë drejtim. Edhe takimet konsultuese me pedagogë në periudhën e rregjistrimit i shërbejnë këtij informimi edhe me akte të tjera rregullative brënda UET.
Kriteri 3 Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës.	Në UET funksionon Zyra e Karrierës. Ajo konsulton, informon, për punësimin dhe lehtëson kontaktet si dhe për mundësinë e doktoraturave.
Standardi IV. 3- Institucioni, kur aplikon për vlerësimin dhe akreditimin për herë të dytë, disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të dytë dhe programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë.	
Kriteri 1 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve në programet e studimeve që kanë përfunduar;	GVJ konstatoi që ekzistonin statistika të plota pranë Zyrës së Protokollit, Arkivit dhe Statistikave lidhur me tregues të programit. Këto statistika merreshin nga zyra e Sekretarisë Mësimore dhe Zyra e Burimeve Njerëzore Institucioni i analizon këto të dhëna për të nxjerrë konkluzione të vlefshme për procesin e vendimmarrjes
Kriteri 2 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të dytë dhe në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik;	UET ka statistika për numurin e të diplomuarve. Janë struktura si Zyra e Protokollit, Arkivit dhe Statistikave që në koordinim me Sekretarinë Mësimore dhe Zyrën e Burimeve Njerëzore dhe Zyrën e Financës analizojnë të dhënat dhe orientojnë mbi këtë bazë vendimet për të ardhmen.
Kriteri 3 Institucioni disponon të dhëna për ecurinë akademike të studentëve që nga pranimi deri në diplomim.	Universiteti ka statistika dhe të dhëna për cdo student për të gjitha rubrikat që lidhen me ta si numuri i studentëve të regjistruar, atyre me bursë, të transferuar, që kanë ndërprerë studimet përkohësisht, të çregjistruar, dhe diplomimet. Për cdo student, ka dosje me të dhëna për

	<p>ecurinë e studimeve. Këto të dhëna ndodhen në Sekretarinë Mësimore dhe në Zyrën e Kujdesit të Studentit.</p> <p>GVJ verifikoi me zgjedhje dosjet e studentëve që plotësohej në vazhdimësi nga sekretaria. Në to kishte të dhëna rreth ecurisë së rezultateve të studentëve të programit.</p>
Standardi IV. 4- Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me statistikat e punësimit të studentëve që janë diplomuar pas përfundimit të programeve e studimeve të ciklit të dytë dhe programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë.	
<p>Kriteri 1 Institucioni mban një bazë të dhënash të studentëve të punësuar pas përfundimit të programeve të studimeve të ciklit të dytë apo të programeve të integruara të studimeve të ciklit të dytë si dhe përvendet e punësimit të tyre;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni mban një bazë të dhënash për studentët që vazhdojnë studimet e mëtejshme në ciklet e tjera të studimeve etj.</p>	<p>Zyra e Karrierës ka krijuar bazë të dhënash për punësimin e studentëve.</p> <p>Nga viti 2009 funksionon Alumni, që zhvillon takime përmirësimet e mundshme në organizimin dhe ofertën akademike të institucionit për t'i përshtatur më mirë kërkesave të tregut të punës. Studentë Alumni janë të përfshirë në Bordet e Tregut të Punës pranë Departamenteve.</p> <p>Nga takimet dhe të dhënat e marra në Zyrën e Karrierës te institucionit pamë që bëheshin përpjekje për të siguruar të dhëna nëpërmjet kontakteve me studentët e diplomuar. Baza e të dhënavë e ngritur në këtë drejtim megjithëse ka pasur përmirësim në aspektin sasior, ende nuk është e plotë, pë shkaqe subjektive të studentëve të diplomuar që shpesh nuk jepin të dhëna ose nuk pëggijen në adresat që kanë depozituar në institucion gjatë zhvillimit të programit.</p> <p>UET mban bazë të dhënash për studentët që vazhdojnë studimet në ciklet e mëtejshme. Tipik është rasti i shkollës së doktoraturës që një pjesë të kandidaturave janë ofruar nga sistemi i ciklit të dytë të studimeve</p> <p>UET organizon çdo vit takimin me UET Alumni. Të diplomuarit zgjedhin një kryetar dhe nëpërmjet tij UET mban lidhje me ta, përtë parë ecurinë e tyre dhe arritjet në sferën profesionale, megjithatë ky informacion për studentët e Msc Financë Bankë nuk është i plotë, për shkak të mos komunikimit me ish student të diplomuar.</p>
Standardi IV. 5- Institucioni informon studentët në mënyrë të vazhdueshme dhe të detajuar, në lidhje me programet e studimeve.	
<p>Kriteri 1 Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programet e studimeve, afatin e përfundimit dhe organizimin e programit, statusin e akreditimit të programit;</p> <p>Kriteri 2 Studentët informohen për rezultatet e vlerësimit gjatë dhe në përfundim të programit;</p> <p>Kriteri 3 Përgjegjësi i modulit diskuton hapur me studentët rezultatet e këtyre vlerësimeve.</p>	<p>Në faqen e internetit apo edhe forma të tjera informimi, si broshura, takime, konsulta, etj, UET ka siguruar informacionin e nevojshëm për programin e studimit, afatin e përfundimit, organizimin e programit, statusin e akreditimit.</p> <p>Nga takimi me studentët morëm informacion se pas secilës detyrë apo provim, pedagogët zhvillojnë seanca sqaruese me studentët, përtë sqaruar paqartësite e mundshme në lidhje me vlerësimin e kryer. Pas kësaj seance</p> 

	<p>pedagogu dorëzon procesverbalin me rezultatet e studentëve</p> <p>Nga viti 2016, në UET ka filluar të përdoret platforma LMS –Learning Management System e cila, rrit mundësitë për informim dhe komunikim me studentët.</p> <p>Pedagogu i lëndës në fund të provimit ballafaqon rezultatet e vlerësimeve brenda orës svaruese</p>
Standardi IV. 6- Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.	
<p>Kriteri 1 Institucioni u ofron këshillim studentëve, ndjek ecurinë e tyre dhe i ndihmon për trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve dhe problematikave që lidhen me procesin mësimor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionalë, në rastet kur parashikohet një e tillë.</p>	<p>Studenti i programit Msc në Finance Bankë si dhe për programet e tjera gjen informacion dhe këshillim në Zyrën e Kujdesit ndaj Studentit, e cila ndjek ecurinë e studimeve të studentit, që nga momenti i regjistrimit, deri në diplomimin e tij. Këshillim ofrohet edhe nga personeli akademik . Zyra e Karrierës këshillon për punësimin, aktivitetet studentore, brenda ose jashtë vendit. Ajo konsulton aplikimin Kjo zyrë ka krijuar kontakte të shumta me kompani private dhe institucione shtetërore dhe bashkëpunon ngushtë jo vetëm në funksion të zhvillimit të praktikave profesionale të studentëve pranë këtyre institucioneve, por edhe në kuadër të punësimit të ardhshëm të studentëve në këto kompani e organizata.</p>
<p>Konkluzionet e vlerësimit:</p> <p>UET ka kritere e dokumentacione të qarta dhe procedura përgjedhjeje për pranimin e studentëve, ka ndërtuar data base për ecurinë e tyre gjatë programit dhe për informimin e studentëve rrëth programeve të studimit. Institucioni ka zbatuar kriteret në pranime, megjithese ne disa raste (nga te dhenat e marra nga institucioni) ka pasur regjistrome te studenteve me note mesatare te ulet 5 apo 5.2. UET ka ofruar informacion mbi programin, aksesin ne infrastructure, mundësitë e punësimit. Shërbimi i kujdesit ndaj studentit funksionon nga momenti i regjistrimit deri në diplomimin e studentit. Këshillimi akademik ka mbështetje nga Zyra e Kujdesit ndaj Studentit dhe Zyra e Karrierës, Ato ofrojnë informacion dhe këshillim akademik për procesin mësimor dhe aktivitetet studentore brenda e jashtë UET. Zyra e Karierës, Alumni Bordet e tregut janë në funksion të përmirësimit të cilësisë, identifikimit të nevojave të tregut, lehtësimit të punësimit, etj.</p> <p>Bazuar ne RVB, takimet e realizuara gjate vizites ne institucion me studentet, zyren e Sekretarise Mesimore, zyren e kujdesit ndaj Studentit dhe Zyren e Karrierës, si dhe verifikimeve ne vend me zgjedhje te dokumenteve te tjera te kerkuara dhe marre nga institucioni konkludojmë se programi i studimit Msc në Finance Banke me dy profile i ploteson plotesisht standardin e kesaj rubrike.</p>	

KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.

10. Kërkimi shkencor

Pjesa përshkrimore



Terma reference: politikat e kërkimit shkencor në këtë program studimi, botimet në vite, projektet e fituara dhe të realizuara, pjesëmarrja në aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, aktivitetet e organizuara nga njësia, lidhja e kërkimit me mësimdhënien.

Kërkimi shkencor, inovacioni dhe mobiliteti i stafit janë pjesë e strategjisë së zhvillimit institucional. UET po ndërmerr hapa proaktiv për të forcuar pikat e forta dhe për të adresuar çdo kufizim të mundshëm. Në veçanti, UET është i fokusuar në avancimin e bashkëpunimit ndërkombëtar për mobilitetet e stafit dhe forcimin e portofolit të kërkimit. Duke filluar nga viti akademik 2010-2011, UET për kërkimin shkencor ka postin e Zv/Rektorit për Kërkimin Shkencor dhe Metodologjinë. Gjatë vizitës në institucion ne u njothëm me Strategjinë e Kërkimit Shkencor të Institucionit i cili përfshin periudhen afatmesme 2017-2020. Vumë re nëpërmjet informacionit që morëm se kjo strategji ishte rrjedhoje e një diskutimi të gjerë të stafit dhe njësive bazë të institucionit. UET është i angazhuar të ndërmarrë kërkim shkencor duke evidentuar vlerat akademike dhe novacioneve në fushat e ekonomisë, inxhinierisë dhe atë sociale

- UET ka ulur numurin e revistave shkencore nga 5 në 2 për të maksimizuar kontributin e burimeve akademike dhe rritur cilësinë e kërkimit e botimit shkencor.
- UET publikon dy revista shkencore ndërkombëtare: Economicus (ISSN: 2223-6295) dhe Polis (ISSN: 2223-8174). Economicus publikon kërkime në fushën e ekonomisë, zhvillimit dhe IT, ndërsa Polis publikon kërkime në fushën e shkencave humane dhe shoqërore.
- UET-i siguron një program trajnimi të strukturuar për stafin akademik në përputhje me gradën shkencore dhe angazhimin në hulumtim. Institucioni ofron trajnime për botimin dhe kryerjen e kërkimeve në grup për stafin akademik.
- Institucioni ofron procedura bashkëkohore të vlerësimit të punës shkencore të stafit akademik. Ne verifikuam jo vetëm indikatorët e performancës kërkimore për pedagogët por edhe vlerësimin e kësaj performance për disa antarë të stafit akademik. Vlerësimi me pikë i kësaj performance ishte i ndarë sipas gradave dhe titujve shkencore.
- Në funksion të performancës së kërkimit shkencor, institucioni mbështet finansiarisht këtë veprimtari për stafin akademik, praktikë kjo bashkëkohore. Lidhja e shpërbimit finansiar me arritje të matshme akademike është një mekanizëm i përshtatshëm për të kontrolluar dhe inkurajuar veprimtarinë shkencore dhe botimet.
- UET ofron trajnime për botimin dhe kryerjen e kërkimeve në grup për stafin akademik.
- UET ka mbështetur finansiarisht kërkimin shkencor duke dedikuar 500,000 euro në vit. Akademikët në UET janë inkurajuar bëjnë punë kërkimore dhe publikojnë, kjo është pjesë e vlerësimit të performances dhe shprehet edhe në kontratat e punësimit. Në bazë të performancës ofrohet grantet kërkimore. Lidhja e shpërbimit finansiar me arritje të matshme akademike është një mekanizëm që aplikohet në UET
- Departamentet: Çdo departament ka planifikuar aktivitetet shkencore (konferanca/ëorkshop-e, kolokume shkencore etj.).
- Mobilitetet Akademike që ofrohen për studentët, stafin dhe kërkuesit për avancimin e kërkimit shkencor dhe rritjen e standartit te produktit të kërkimit shkencor. Zyra e marrëdhënieve ndërkombëtare në UET kontribuon në marrëveshjet e bashkëpunimit me universitete të BE.

UET ka ofruar lehtësi administrative, si leja e paguar, zëvendësimi i orëve të mësim-dhënies.

Për periudhën 2015-2017 UET ka zbatuar 12 Marrëveshje Ndër-institucionale brenda Erasmus + ICM si dhe menaxhimin e projektit SIGMA Agile Tempus. Këto projekte përqëndrohen në shkëmbimin e stafit dhe studentëve. Shkëmbimet bëhen në nivel të studentëve, personelit administrativ si dhe stafit akademik. Lëvizshmëria e studentëve të doktoraturës dhe stafit akademik përfshin hulumtime në fusha specifike.

Të dhëna për aktivitete shkencore dhe përfshirjen e studentëve në to jepen në **Tabelën 17** në **Aneks**.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna për kërkimin shkencor**



Kerkimi shkencor në UET realizohet nëpërmjet a) botimit të 2 revistave shkencore në gjuhë të huaj; b) ndërtimit të një sistemi vlerësimi me pikë të performancës të stafit akademik, dhe në funksion të kësaj mbështetje me grande financimi të stafit në këtë fushë; mobiliteteve të stafit akademik në kuadër të projekteve, bashkëpunimeve shkencore që ka institucioni me ato homologe brenda dhe jashtë vendit.

Numri i botimeve nga personeli akademik efektiv i IAL

Mbështetur në të dhënrat e institucionit numri i botimeve nga PAE i institucionit gjatë 3 viteve të fundit është 456 botime brenda dhe jashtë vendit. Pjesë e konsiderueshme e këtyre botimeve janë pranë dy revistave shkencore që boton vetë institacioni. Nxitja e publikimeve shkencore nga PAE është rrjedhojë edhe e metodologjisë së vlerësimit të performancës shkencore nga institacioni.

Numri i projekteve kërkimore të fituara

Mbështetur në të dhënrat e institucionit, numri i projekteve kërkimore të fituara është 11, ku shumica janë në kuadër të projektit ERASMUS +.

Numri i projekteve të zbatuara, Numri i aktiviteteve shkencore të organizuara nga IAL, Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore brenda IAL, studentëve të përfshirë në kërkimin shkencor

Mbështetur në të dhënrat e institucionit, numri i projekteve kërkimore të zbatuara deri tani është 20, numri i aktiviteteve shkencore të organizuara nga institacioni është 13, dhe numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore brenda institucionit eshte 270 Mbështetur në të dhënrat e institucionit, numri i studentëve të përfshirë në kërkimin shkencor është 17. Bazuar në numrin total të studentëve në vite mendojmë se ky numer është shumë minimal. Gjithashtu, asnjë nga studentët e programit MP në Financë me 5 profilet nuk ka qenë i perfshirë në kërkimin shkencor. Kjo është edhe rrjedhojë e natyrës së programit me karakter më shumë aplikativ, por edhe i nivelit cilësor të ulët në hyrje të studentëve të këtij programi

Numri i kërkimit shkencor me procesin mësimor


Ska


Në mënyrë të veçantë, gjatë periudhës 2015-2017 UET ka qenë institucioni dërgues i 51 anëtarëve të stafit, 30 prej të cilëve ishin mobilitete për qëllime kërkimore / mësimore.

Për të njëjtën periudhë UET ka pritur 18 punonjës nga universitetet e BE-së, 15 prej të cilëve kanë kryer aktivitete hulumtuese / mësimore. UET ka pritur 13 studentë të huaj, nga të cilët 6 kërkues doktorantë dhe 1 student MA që ka kryer kërkime për tezën e tij. Nga UET ne universitetet e BE, janë dërguar 38 studentë, nga të cilët 6 studentë të doktoraturës. UET ka nënshkuar marrëveshje bashkëpunimi me CEU-Budapest dhe është bërë pjesë e Programit CEU të Ndihmës Globale. Së fundmi UET do të jetë institucioni pritës për lektorët dhe kandidatët e avancuar të doktoratës të CEU, të cilët do të jalin mësim dhe ndërmarrin kërkim shkencor në UET. Gjithashtu, për vitin akademik 2017-2018 UET ka aplikuar për 31 marrëveshje Erasmus + për të mundësuar mobilitete për 207 studentë dhe kërkues.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardi/Kriteret	Vlerësimi sipas standardeve
Standardi III.3 - Personeli akademik angazhohet në veprimtari shkencore të organizuara në kuadër të programit të studimeve.	
Kriteri 1 Personeli akademik publikon rregullisht artikuj, materiale shkencore në disiplinën përkatëse;	Vlerësimi me bonus finansiar nëpërmjet marrjes së gradeve nga institucioni për



<p>Kriteri 2 Personeli akademik, nëpërmjet angazhimeve në këto veprimtari jep ndihmesën e tij në zhvillimin e shkencës ose në zhvillimin e sektorëve të prodhimit apo të shërbimit.</p>	<p>performancë shkencore të stafit ka stimuluar që PAE të publikojë rregullisht artikuj, materiale shkencore në disiplinën përkatëse në revistat e institucionit, jashtë tij dhe në botimet në revista të huaja</p> <p>Në vleresimin e indikatoreve të performancës shkencore për stafin shohim se artikujt në këto revista cilësore kanë edhe vleresimin me pikë më të lartë</p> <p>Po synohet rritja e cilësisë botimeve për publikime në revista me faktorë impakti mundësish Thomson Reuters.</p> <p>Cdo pedagog në bazë të kontratës së nënshkruar me UET ka të përcaktuar numrin e pikëve që duhet të grumbullojë në bazë të titullit dhe gradës.</p>
<p>Standardi III.4 - Institucioni ofron programe mësimdhënieje edhe në gjuhë të huaj, me një personel akademik të kualifikuar.</p>	
<p>Kriteri 1 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka kryer studimet universitare në atë gjuhë ose zoteron një certificate për njohje të avancuar të saj;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik që angazhohet në mësimdhënie në gjuhë të huaj ka një përvjoe në mësimdhënie në atë gjuhë, prej së paku një semestri.</p>	<p>UET nuk ofron programe mësimdhënie në gjuhë të huaj, ndonse ka kapacitete për këtë. Pedagogë të departamentit janë angazhuar në mësimdhënie në gjuhë të huaj në disa Universitete Europiane në gjuhën angleze. Nga këta profesorë mund të përmendim: Prof. Dr. Luljeta Minxhozi dhe Prof. Asoc. Dr. Selami Xhepa. Këta pedagogë kanë përvjoe mësimdhënieje në universitete të huaja prej mbi një semestri.</p>
<p>Standardi III.10 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimorshkencor;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni u ofron personelit akademik dhe atij mësimor-shkencor mundësinë e kualifikimeve të mëtejshme brenda dhe jashtë vendit.</p>	<p>UET ka organizuar hera herës mbi bazë Departamenti leksione të hapura nga pedagogë apo specialistë të niveleve të larta të huaja. Ndërkojë lipset të hartohen programe specifike për kualifikimin professional të stafit, sidomos të të rinjve.</p> <p>Aktiviteti Staff Development Day – Dita e Zhvillimit të Stafit në fusha të lidhura me mësimdhëni, kërkimin, projektet, metodologjinë dhe TIK, eshtë një dukuri për tu vlerësuar.</p> <p>Për përfshirjen e stafit në projekte ndërkombëtare, funksionon dhe operon Zyra e Zhvillimit të Projekteve dhe Kërkimit.</p> <p>Nga informacioni i marrë dhe i verifikuar gjatë takimit në institucion me stafin akademik të këtij programi, PAE i Departamentit të Financës dhe Ekonomiksit janë angazhuar në programe kërkimore nëpërmjet pjesëmarrjes në projektet e UET-së dhe jashtë tij ku institucioni është partner në to. Disa nga këta antarë të stafit kanë qenë në vizita pranë universiteteve të huaja për periudha që varrojnë nga 1 deri 6 muaj.</p> 

	Nga biseda në institucion u theksua se afro 60 % e PAE janë të perfshirë në projekte të tilla
Standardi III.11 - Institucioni disponon një bazë të dhënash në lidhje me veprimtarinë kërkimore-shkencore të personelit akademik të tij.	
Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të studimeve shkencore të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;	Deapartamenti i Financës dhe Ekonomiks-it ka në dispozicion axhendën kërkimore të secilit pedagog në harkun e 5 viteve, si dhe një bazë të plotë të dhënash të punës kërkimore, botimeve dhe pjesmarrjeve me kumtesë në konferanca brenda dhe jashtë vendit të stafit në cdpo fund viti akademik..
Kriteri 2 Institucioni disponon një bazë të dhënash për botimet (tekste, monografi, libra, artikuj apo kumtesa në konferenca) brenda e jashtë vendit të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi;	Zyra e Zhvillimit të Projekteve dhe Kërkimit në UET disponon një bazë të dhënash (Excel spreadsheet) me detaje të projekteve kërkimore, zhvillimi, ndërtim-kapacitetesh etj. në të cilat ka marrë pjesë personeli akademik, si dhe me detaje të projekteve në aplikim/të ardhshme. Baza e të dhënavë përmban detaje për projektin, për donatorin, për partnerët, për personelin akademik të përfshirë.
Kriteri 3 Institucioni disponon një bazë të dhënash për projektet kërkimore shkencore kombëtare e ndërkombëtare në të cilat ka marrë ose merr pjesë personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi.	Ka një bazë të të dhënavë për projekte kërkimore, zhvillimi, ndërtim-kapacitetesh etj. ku ka marrë pjesë ose është i përfshirë personeli akademik. Këto të dhëna disponohen nga Zyra e Zhvillimit të Projekteve dhe Kërkimit në UET

Konkluzionet e vlerësimit:


UET synon të ndërlidhë eksperiencat me universitet e huaja në mësimdhënie apo marrje eksperience për doktorantët e rinj. Ka system informacioni për punimet nga pedagogët në file të hapura nga UET. UET ka progres në organizimin dhe bashkërendimin e punës kërkimore shkencore të personelit akademik, në shkallë departamenti e më gjerë. Infrastruktura në dispozicion të angazhimit të pedagogëve në veprimtari kërkimore shkencore është përmirësuar. Departamenti planifikon veprimtaritë shkencore të tijat ose me departamente të tjera, ose universitete partnere. Institucioni ka të dhëna për projektet dhe kerkimin shkencor të stafit, ka strutura të ngritura e funksionale si Zyra e Zhvillimit të Projekteve. Gjithashtu ka mundësi dhe duhet të piketojë ofrimin e programeve në gjuhë të huaj, kapacitetet me staf janë dhe mund të plotësohen.

Cdo fakultet ka revistë shkencore, ato ofrojnë mundësi për publikimin e punës kërkimore të stafit akademik kërkues.

Bazuar në RVB, takimet e realizuara gjatë vizitës në institucion me drejtues të tij, zyrën e projekteve, si dhe verifikimeve në vend të botimeve në revistat shkencore të botuara nga institucioni por edhe me gjerë, konkludojmë se programi i studimit Msc Finance Banke, i ploteson kryesisht standardin e rubrikës së kërkimit shkencor.

Rekomandie;

- a. Në funksion të kërkimit shkencor mendojmë se në kuadër edhe të strategjisë afatmesme të kërkimit shkencor të institucionit, ky i fundit duhet të synojë rritjen e numrit të studenteve te Msc në Finance Banke në kerkimin shkencor pasi numri i tyre është i ulët si dhe pjesëmarrjen më të gjerë të tyre në veprimtari shkencore të organizuara nga vetë institucioni por edhe jashtë tij.*
- b. Institucioni krahas me zgjerimin sasior e cilesor te stafit mund te shohe edhe ofrimin e programeve ne gjuhe te huaj, anglisht, objektiv ky qe duhet te konceptohet qe tanë e ne perspective.*



11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombe tar dhe marrëdhëniet me publikun

Pjesa përshkrimore

Terma reference: bashkëpunimi me institucionet e tjera në nivel lokal, kombëtar apo ndërkombe tar, mobiliteti i personelit akademik në secilin nga nivelet e sipërpërmendura, pjesëmarrja në programe kombëtare dhe ndërkombe tar, lidhjet me komunitetin e biznesit dhe me tregun e punës

UET gjatë 3 viteve të fundit akademike(2014-2017) ka rritur nivelin e bashkëpunimit në nivel lokal dhe ndërkombe tar, gjë që kontribon në marrjen e praktikave më bashkëkohore akademike në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies lidhur me personelin akademik dhe studentët. Bazuar në të dhënat e marra gjatë vizitës në institucion dhe RVB, institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi në nivel lokal partneritet, shkëmbime akademie apo Erasmus + , me 15 institucione të arsimit të lartë në Shqipëri dhe me 16 institucione të tjera të shoqërisë publike. Zhvillim pozitiv në këtë fushë shohim në marrëveshjet e bashkëpunimit ndërkombe tar të institucionit. Kështu gjatë kësaj periudhe ka pasur apo janë në proces bashkëpunimi me rreth 93 universitete apo institucione Europiane në kuadër të projekteve të ndryshme ERASMUS + , partnership etj. Nga ky numër 6 marëveshje bashkëpunimi janë me Universitetet në Kosovë. Ky numer i madh marrëveshjesh bashkëpunimi që ka përfshirë të tre nivelet e programeve mësimore që zhvillohen ka mundësuar edhe realizimin e mobiliteteve në kuadër të shkëmbimeve të stafit, personelit administrativ dhe studentëve të UET-së, me këto institucione partnere. Gjatë kësaj periudhe janë dërguar tek këto universitete partnere 51 antarë të stafit ku 30 prej tyre kanë qenë mobilitete për qëllime kërkimore / mësimore. Për të njëjtën periudhë UET ka pritur 18 punonjës nga universitetet e BE-së, 15 prej të cilëve kanë kryer aktivitete hulumtuese / mësimore. Në këtë kuadër UET ka pritur 13 studentë të huaj, nga të cilët 6 kërkues doktorantë dhe 1 student MA që ka kryer kërkime për tezën e tij. Sa u përket studentëve që shkojnë nga UET ne universitetet e BE, UET ka qenë institucioni dërgues i 38 studentëve, nga të cilët 6 studentë të doktoraturës. Aktualisht, UET ka nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi me CEU-Budapest dhe është bërë pjesë e Programit CEU të Ndihmës Globale. Duke filluar nga shtatori 2017, UET do të presë lektorët dhe kandidatët e avancuar të doktoratës të CEU, të cilët do të jalin mësim dhe ndërmarrin kërkim shkencor në UET. Gjithashtu, për vitin akademik 2017-2018 UET ka aplikuar për 31 marrëveshje Erasmus + për të mundësuar mobilitete për 207 studentë dhe kërkues. Një ndërmarrje e rëndësishme e UET duhet konsideruar edhe ndërtimi i rrjetit 'Next Europe', nën kujdesin e Zyrës së Projekteve për Kërkim dhe Zhvillim. Ky rrjet synon të trajtoj me përparësi problematikën e demokratizimit, zhvillimit ekonomiko-shoqëror dhe institucional të vendeve të Ballkanit Perëndimor duke u fokusuar tek parametrat e modernizimit dhe europianizimit të tyre si në planin politik ashtu edhe ekonomik e social. UET ka tashmë marrëveshje institucionale për kërkimin shkencor me La Sapienza University of Rome, Itali, me fokus seminare doktorale si dhe Central European University, Budapest, me fokus programin "Global Teaching Fellowship për shkëmbim stafi akademik.



Institucioni mbështet edhe aplikimet individuale të stafit akademik në kuadër të projekteve të zhvillimit të kapaciteteve të arsimit të lartë si Erasmus+ KA1 dhe KA2 të Komisionit European; të projekteve kërkimore dhe rrjetëzimit si COST dhe Horizon2020 të Komisionit European etj.

Sipas tabelës 20 të RVB, ka marrëdhënie bashkëpunimi në kuadrin erazmus apo mobilitete të tjera me 94 universitete perëndimore dhe te lindjes dhe 15 universitete brenda vendit.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombe tar shih treguesit e mëposhtëm(sipas RVB)**

1	Numri i pjesëmarrësve si partnerë në projekte Kombëtare apo ndërkombe tar	13
---	--	----



2	Numri i Leksioneve dhe seminareve me lektorë të huaj (ose orë mësimore)	37
3	Numri i pjesëmarrësve në trainime fushën e kërkimit shkencor jashtë vendit	30 (erasmus + staf akademik)
4	Mobiliteti i studentëve nga dhe drejt programit të studimit	13 student kanë ardhë në UET përmes bursave Erasmus + 38 student nga UET kanë përfituar bursa Erasmus + 19 student të UET kanë lëvizur përmes programeve të tjera të BE (SIGMA) dhe programeve bilaterale
5	Infrastruktura në funksion të kërkimit shkencor	Biblioteka, Abonimi në EBSCO, SAGE online si edhe të tjera burime online; Laborator IT; infrastrukturë anti-plagiarizëm; Salla konferencash dixhiitale; trajnimi i brendshëm i stafit akademik: Kërkimi me Impakt; Si të komunikojmë Shkencën; UET Research group; Si të aplikojmë për projekte; etj. Ditët Doktorale; Revistat Shkencore (Economicus dhe Polis); Ditë Informative për grante kërkimore në nivel European (AKTI, RCE, etj.); Ditët e Studimeve Shqiptare;
6	Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore jashtë IAL/ jashtë vendit dhe prezantime	21 (erasmus + staf administrativ)
7	Numri i Çmimeve ndërkombëtare në fushën e kërkimit shkencor.	1

- Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjera shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë jepen në treguesit e mëposhtëm(sipas RVB).**

Institucionet të shoqërisë civile dhe ndërkombëtare si partnerë/donatorë		
Këshilli Britanik	Tiranë	Provimet IELTS
Ambasada e Britanisë në Tiranë	Tiranë	Programe shkëmbimi
Komisioni European	Bruksel	Jean Monnet Chair/Tempus
Mediterranean Citizens' Assembly	Francë	Zhvillimi i Mesdheut
Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ)	Tiranë	Mekanizmi gjurmues për të diplomuarit në tregun e punës
Groëth for Knowledge - GFK + GFK Verein	Austri	Kërkim tregu - Trajnim
NUFFIC – Ambasada Hollandeze	Tiranë	Trajnim për zhvillimin e kapaciteteve të Qendrës UET dhe ITAP
UNICEF	Tiranë	Gjithëpërfshirja shoqërore dhe të drejtat e njeriut
UNDP	Tiranë	Lufta kundër korruptionit dhe roli I universitetit
Ambasada e SHBA-ve	Tiranë	Forcimi I sigurisë njerëzore nëpërmjet rritudes së pjesëmarres së komunitetit
